



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 10/2020 regjistëri (JR)
Datë 17.02.2020

Nr. 32 i vendimit
Datë 28.07.2022

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Natasha Mulaj	Kryesuese
Rezarta Schuetz	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Ina Rama	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

- mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, më datë 28.07.2022, ditën e enjte, në orën 10.00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Gerrit Sprenger, me sekretare gjyqësore Adelajda Hiska, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit, z. Arjan Balliu, gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Durrës.

OBJEKTI I ANKIMIT: Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 211, datë 18.11.2019, që i përket subjektit të rivlerësimit, z. Arjan Balliu.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni F, pika 2, i Aneksit të Kushtetutës; neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 62, 63, 65 e vijues të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

TRUPI GJYKUES I KOLEGJIT TË POSAÇËM TË APELIMIT,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim, i cili përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 211, datë 18.11.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Rezarta Schuetz, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Arjan Balliu me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 84/2016 ushtronte funksionin e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Durrës. Në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ai iu nënshtrua procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka plotësuar dhe dërguar brenda afatit ligjor në organet përkatëse ndihmëse, deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit (në vijim “deklarata vetting”), në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, deklaratën për kontrollin e figurës pranë Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.
3. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka administruar raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtorja e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGJ”), sipas të cilave ka rezultuar:
 - 3.1. ILDKPKI-ja¹, në zbatim të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, ka konstatuar se: (i) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin dhe ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor; (ii) nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; (iii) ka kryer fshehje të pasurisë ndër vite nga bashkëshortja (subjekt deklarues) në vitin 2007; (iv) ka kryer deklarim të rremë; (v) subjekti ka ushtruar funksionin në situatën e konfliktit të interesave.
 - 3.2. DSIK-ja², sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Arjan Balliu.
 - 3.3. KLGJ-ja ka rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe pesë dokumentet e tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi rastësor, si dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.³

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

4. Me vendimin nr. 211, datë 18.11.2019, Komisioni ka vendosur: “*Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Arjan Balliu, gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Durrës*”.
5. Vendimi për subjektin e rivlerësimit është marrë nga Komisioni bazuar vetëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë, për të cilin është konkluduar se:
 - ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe kryerjen e shpenzimeve për periudhën 1991 – 2016;
 - ka bërë deklarim të pamjaftueshëm për të ardhurat;
 - ka bërë deklarim të pasaktë dhe të rremë lidhur me pasuritë e krijuara dhe burimin e ligjshëm;

¹ Raporti nga ILDKPKI-ja dërguar me shkresën nr. {***} prot., datë 12.02.2018.

² Raporti nga DSIK-ja dërguar me shkresën nr. {***} prot., datë 31.10.2017.

³ Raporti nga KLGJ-ja dërguar me shkresën nr. {***} prot., datë 10.07.2019.

- ka bërë deklarinim të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, në kuptim të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016;
- nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive të tij dhe personave të lidhur, në kuptim të nenin D, të Aneksit të Kushtetutës;
- është gjendur në situatën e konfliktit të interesit.

III. Shkaqet e ankimit

6. Subjekti i rivlerësimit Arjan Balliu, në respektim të afateve dhe kërkesave ligjore, më datë 04.02.2020, ka ushtruar ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”) kundër vendimit të sipërcituar të Komisionit, për aspekte procedurale dhe për themelin.
7. Lidhur me procesin e rregullt ligjor dhe aspektet procedurale të procesit të rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se:

7.1. Procedura e rivlerësimit e kryer nga Komisioni është në shkelje të parimeve bazë të parashikuara në Kushtetutë, si dhe në Kodin e Procedurave Administrative (në vijim “Kodi i Procedurave”), si: parimi i transparencës, parimi i informimit, parimi i objektivitetit, parimi i drejtësisë dhe paanësisë, parimi i komunikimit me palët. Nga Komisioni nuk është respektuar e drejta e subjektit për t’u njohur me materialet e dosjes, si dhe për të marrë një kopje të tyre (neni 45 i Kodit), e drejta për të paraqitur mendime dhe shpjegime në lidhje me çështjen (neni 47), e drejta për të bashkëpunuar gjatë hetimit administrativ (neni 78), e drejta për të kërkuar prova dhe dokumente të tjera (neni 80), e drejta për të paraqitur prova dhe informacione të tjera (neni 84), e drejta për t’u dëgjuar për provat e paraqitura (neni 87).

7.2. Vendimi i Komisionit për rrëzimin e disa kërkesave të tij për marrjen e provave është i paarsyetuar, sipas nenit 49 të ligjit nr. 84/2016 dhe i paargumentuar për shkaqet e rrëzimit. Pavarësisht nga provat shkresore të paraqitura prej tij dhe kërkesës për këqyrje dhe pyetjen e dëshmitarëve, Komisioni nuk ka pranuar provat thelbësore që justifikojnë burimet e ligjshme të pasurive. Kjo përbën mospërmbushje të detyrimit kushtetues të organeve të rivlerësimit që të kryejnë një sërë veprimesh për të konfirmuar vërtetësinë dhe saktësinë e deklarimeve të subjekteve në procesin e rivlerësimit. Neni 45 i ligjit nr. 84/2016 përcakton që Komisioni duhet të hetojë e vlerësojë të gjitha faktet e nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Kjo kompetencë funksionale, thekson subjekti i rivlerësimit, limitohet deri në kufirin kur provat arrijnë nivelin e provueshmërisë, sipas vlerësimit të Komisionit.

7.3. Komisioni i ka mohuar të drejtën për t’u njohur me materialet e dosjes, specifikisht me relacionet e çështjes të përgatitura nga këshilltari juridik dhe ekonomik, me shpjegimin që këto relacione janë dokumente të brendshme që nuk mund t’i vihen në dispozicion.

7.4. Në kundërshtim me deklarinimin e kryesueses së trupit gjykues, e cila në seancën e datës 11.11.2019 u shpreh se shtyhet seanca për në datën 18.11.2019, për të vlerësuar provat dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, më datë 12.11.2019, Komisioni ka nxjerrë njoftimin se në datën 18.11.2019 do të shpallet vendimi për subjektin e rivlerësimit Arjan Balliu. Në seancën e datës 18.11.2019, trupi gjykues e ka përfunduar seancën dëgjimore në mungesë të subjektit të rivlerësimit, duke shpallur menjëherë vendimin.

7.5. Si hetimi paraprak, ashtu edhe gjykimi janë zhvilluar me pjesëmarrjen e relatorit dhe anëtarëve të trupit gjykues, dhe ky procedim sipas subjektit të rivlerësimit bie në kundërshtim me nenin 6 të KEDNj-së. Një dublim i tillë i funksioneve mund të hedhë dyshime objektive në paanshmërinë e këtyre anëtarëve, pasi parimi i ndarjes së funksioneve ka qenë i zhdukur plotësisht.

7.6. Trupi gjykues që ka gjykuar çështjen nuk është krijuar, sipas pikës 1, të nenit C të Aneksit të Kushtetutës, pasi nuk rezulton të jetë një trup gjykues i përhershëm.

7.7. Anëtarëve të Komisionit u mungon profesionalizmi dhe përvoja për të trajtuar çështjet komplekse në themel të procesit të *vetting*-ut dhe asnjë prej tyre nuk ka përvojën e nevojshme juridike dhe/ose gjyqësore dhe aftësi për gjykimin e çështjeve.

7.8. Vlerësimi përfundimtar i Komisionit, bazuar vetëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë, përbën shkelje të rëndë të nenit 6 të KEDNJ, të pikës 1, të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 e detyrojnë Komisionin të kryejë procesin e rivlerësimit bazuar në vlerësimin e përgjithshëm të tri kriterëve në mënyrë të domosdoshme.

7.9. Duke mos i komunikuar qartë dhe në mënyrë të plotë rrethanat që prodhojnë prezumimin ligjor në favor të masës disiplinore, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit një barrë prove tej mundësive objektive për paraqitjen e provave shkresore, të cilat nuk gjenden as në institucionet shtetërore dhe janë jashtë afatit ligjor të ruajtjes së tyre.

7.10. Komisioni është bazuar në vendimin e tij vetëm në të dhënat dhe provat e aktit përfundimtar të kontrollit të pasurisë të ILDKPKI-së. Ky akt, është absolutisht i pavlefshëm, sipas nenit 108/ç të Kodit të Procedurave Administrative, pasi është depozituar në Komision përtej afatit ligjor “*jo më vonë se 180 ditë nga dita e depozitimit të deklaratës së pasurisë nga subjekti i vlerësimit*” të parashikuar në nenin 33, pika 4 e ligjit 84/2016. Ky dokument nuk duhej të merrej në konsideratë nga Komisioni si një akt absolutisht i pavlefshëm që nuk mund të sjellë asnjë pasojë juridike ndaj subjektit të rivlerësimit.

7.11. Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka vepruar në kundërshtim me nenin 61 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit *shkarkimi nga detyra i subjektit të rivlerësimit jepet si masë disiplinore...1. Kur rezulton se ka deklaruar më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme gjatë vlerësimit të pasurisë...* Në rastin e tij nuk përmbushet kushti ligjor i *deklarimit të më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme*, rrethanë e cila do të përbënte një shkak të ligjshëm për dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

8. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë, subjekti ka parashtruar në mënyrë të përmbledhur si vijon:

8.1. *Në lidhje me apartamentin 1+1+aneks, me sipërfaqe 70,8 m², së bashku me garazh me sipërfaqe 12,5 m², në rrugën “{***}, pall. {***}, shk. {***}, ap. {***}, Tiranë*

- i) Deklarimi i shumës 15.000 USD në deklaratën periodike për vitin 2004 ka qenë një gabim, nisur nga fakti se kanë qenë deklarimet e para, si dhe për shkak të paqartësive dhe mosinformimit nga ILDKPKI-ja.
- ii) Burim i kësaj pasurie kanë qenë kursimet familjare dhe të ardhurat nga pagat e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes në vitet 1991-2001 dhe vlera 1.000.000 (një milion) lekë, që është një pjesë e përfutur nga puna dhe të ardhurat si emigrant ekonomik në Greqi të babait të subjektit. Komisioni nuk ka marrë në konsideratë të ardhurat e bashkëshortes për vitet 1999-2000 dhe për vitin 2001.
- iii) Komisioni ka aplikuar kursin e konvertimit më të pafavorshëm Lekë-USD për periudhën 1991-2001, duke iu referuar kursit të këmbimit të vitit 2001.
- iv) Në llogaritjen e shpenzimeve të jetesës janë përfshirë shifra diskriminuese dhe jashtë çdo lloj logjike ekonomike dhe jetësore. Komisioni ka përfshirë si shpenzime jetese për fëmijën edhe periudhën shkurt-mars 2000, ndërkohë që ai ka lindur në 02.04.2000.
- v) Kontrata e shitjes së apartamentit vjehrrës, në vitin 2012, në vlerën 8.800.000 lekë, është bërë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, duke shlyer dhe detyrimet tatimore me një vlerë reale pasurie pas rivlerësimit të pronës. Detyrimi për kalimin e vlerës monetare të shitjes nëpërmjet sistemi bankar është vendosur në vitin 2013. Të ardhurat e krijuara nga vjehri dhe vjehrra për blerjen e kësaj pasurie provohen nga kontratat e qirasë për pasuritë në pronësi të tyre për periudhën 2003-2012.

- vi) Shuma e përfituar nga shitja e apartamentit është deklaruar në deklaratën periodike për vitin 2012, por deklarimi i gjendjes *cash* si pjesë e deklarimit periodik është vendosur vetëm pas miratimit të ligjit nr. 45/2014.
- vii) Pasuria nr. {***} është deklaruar në deklaratën *vetting*, si vendbanim në rubrikën “*Të dhëna personale të subjektit dhe personave të lidhur*”, duke ezauruar në mënyrë shteruese deklarimin e përdorimit të kësaj pasurie.

8.2. Në lidhje me apartamentin 1+1 me sipërfaqe 70 m², me nr. pasurie {*}, z. k. {***}, me adresë rruga “{***}”, hyrja {***}, ap. {***}, Tiranë, blerë me kontratën nr. {***}, datë 17.12.2015, në vlerën 2.000.000 lekë**

- i) Në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës në vitin 2009, nuk është bërë deklarim i pasaktë, pasi në këtë dokument është deklaruar vlera e blerjes, si dhe vlera e shpenzimeve (investime dhe arredime). Mosdetajimi në deklaratën periodike nuk mund të konsiderohet si deklarim i rremë ose i pasaktë.
- ii) Pasuria ka si burim të ligjshëm të ardhurat nga avokatia, për të cilat janë paguar detyrimet tatimore në organet kompetente. Subjektit i është ofruar apartamenti pa pagesë si shpërblim për punën e kryer si avokat për shoqërinë “{***}”. Kjo marrëveshje është formalizuar me kontratën noteriale të sipërmarrjes, më datë 22.10.2007, në vlerën 2.000.000 lekë.
- iii) Nuk ka asnjë konflikt interesi të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me z. A. Gj. dhe, për pasojë, nuk gjendet konflikti i interesit. Z. A. Gj. ka qenë përfaqësues me prokurë i shoqërisë “{***}” vetëm për nënshkrimin e kontratës së shitblerjes së pasurisë me adresë rruga “{***}”, hyrja {***}, ap. {***}, Tiranë. Detyrimet ndaj shoqërisë për këtë pasuri janë shlyer që në vitin 2007. Gjykimi i shtetasit A. Gj. në Gjykatën e Apelit Durrës, në të cilin subjekti i rivlerësimit ka qenë kryesues, është zhvilluar në bazë të shortit të hedhur në gjykatë.

8.3. Në lidhje me automjetin [tip Audi A3, me targë {*}], blerë me kontratën e shitjes, datë 8.11.2012, me vlerë 25.000 euro**

- i) Si burim për blerjen e automjetit kanë shërbyer kursimet nga paga dhe të ardhura të përfituara nga shitja e apartamentit në rr. “{***}, pall. {***}, shk. {***}, ap. {***}, Tiranë.
- ii) Lidhur me të ardhurat e krijuara nga shitja e apartamentit vjehrrës L. V., si dhe burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, subjekti i referohet të njëjtave argumente të paraqitura më sipër në lidhje me këtë pasuri.

8.4. Në lidhje me Bonot e Thesarit, për periudhën 24.6.2004-24.12.2007, në vlerën 3.000.000 lekë

Subjekti i rivlerësimit ka parashtruar në ankim se burimi i krijimit për vlerën 1.500.000 lekë janë kursime nga të ardhurat nga pagat e tij dhe të bashkëshortes dhe 1.500.000 lekë të tjera janë depozituar në favor të vjehrrit (për pamundësi fizike). Vlera e depozituar në emër të vjehrrit ka pasur si burim të ligjshëm të ardhurat e përfituara nga dhënia me qira e pronave, vlerën e përfituar nga vendimi gjyqësor, si dhe pensionet e vjehrrit dhe vjehrrës.

8.5. Në lidhje me llogari bankare [në “Raiffeisen Bank”], me vlerë 550.375 lekë

Subjekti i rivlerësimit pretendon se burim i krijimit të kësaj llogarie janë kursimet familjare nga pagat që kanë ardhur një pjesë nga gjendja *cash* në banesë dhe pjesa tjetër nga shitja e apartamentit me sip. 70, 8 m², në shumën 8.800.000 lekë vjehrrës. Vlerat monetare mbaheshin së bashku *cash* në banesë. Detyrimi për deklarimin e gjendjes *cash* në banesë ka lindur në vitin 2014.

8.6. Në lidhje me gjendjen cash në banesë në vlerën 1.000.000 lekë deklaruar në deklaratën vetting

Subjekti i rivlerësimit parashtron se termi *cash* u vendos detyrimisht si pjesë e deklaratimit periodik, vetëm pas miratimit të ligjit nr. 45/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”. Edhe nga përmbajtja e formularëve periodikë për vitet 2003-2014 rezulton se nuk është kërkuar deklarimi i vlerës *cash* jashtë sistemit bankar. Ndërsa si burim i krijimit i gjendjes *cash* janë kursimet familjare dhe të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit me sip.70,8 m², në shumën 8.800.000 lekë.

8.7. Në lidhje me apartamentin me sip. 123 m², në {***}, Kavajë

- i) Bashkëshortja nuk ka vepruar asnjëherë me cilësinë e pronares së truallit, këtë cilësi e ka pasur nëna e saj dhe ia ka caktuar që në fillim pjesën takuese bashkëshortes.
- ii) Nëna e bashkëshortes, në cilësinë e pronares së truallit, ka lidhur kontratë sipërmarrjeje më datë 13.01.2004, me shoqërinë “{***},” me qëllim shkëmbimin e truallit me sipërfaqe ndërtimi.
- iii) Kontrata e porosisë e lidhur nga bashkëshortja me shoqërinë “{***}” është bazuar në kontratën fillestare të lidhur nga nëna e saj në datën 13.01.2004. Dhënia e cilësisë si pronare trualli bashkëshortes në kontratën e sipërmarrjes të datës 30.10.2004, është një lapsus i noterës gjatë hartimit të kësaj kontrate.
- iv) Sipas kontratave të mësipërme, vjehrra do të përfitonte 3 (tre) apartamente dhe një garazh në këmbim të truallit. Në kontratën fillestare të datës 13.01.2004 rezulton se bashkëpronarët e tjerë të truallit kanë përfutuar secili 4 njësi, për të njëjtën sipërfaqe trualli të dhënë për ndërtim.
- v) Vlera prej 4.500.000 lekësh, e parashikuar në kontratën e blerjes [nr. {***}], datë 26.11.2007, nuk është paguar realisht as nga vjehrra dhe as nga bashkëshortja, pasi kjo kontratë ka qenë pjesë e shkëmbimit të truallit me sipërfaqe ndërtimore.

8.8. Në lidhje me llogarinë në “Credins Bank”, me vlerë 500.106 lekë

Subjekti i rivlerësimit parashtron se gjithë shuma e ekzekutimit të vendimit gjyqësor ka kaluar në emër të trashëgimtarëve të vjehrrit të subjektit, pasi dy palët e tjera në procesin gjyqësor kanë rënë dakord të mos kenë asnjë pretendim për përfitimin e kësaj shume.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

9. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion *ratione materiae* për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, për rivlerësimin e subjekteve të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç vendimeve të dhëna, sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, që ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit Arjan Balliu, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

10. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar

pranë Komisionit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit⁴, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 e ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

11. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit, kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues në vijim vendos se plotësohen kriteret e nenit 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”), për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit nr. 211, datë 18.11.2019, të Komisionit, u mor në shqyrtim nga trupi gjykues i Kolegjit në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, më datë 28.07.2022.

B. Mbi shkaqet e ankimit për procesin e rregullt ligjor

12. Subjekti i rivlerësimit parashtron se Komisioni ka shkelur parimet bazë të Kushtetutës dhe Kodit të Procedurave Administrative, si dhe nuk ka respektuar një sërë të drejtash të subjektit si: të drejtën e tij për t’u njohur me materialet e dosjes dhe për të marrë një kopje të tyre, të drejtën për të paraqitur mendime dhe shpjegime në lidhje me çështjen, të drejtën për të bashkëpunuar gjatë hetimit administrativ, për të kërkuar prova dhe dokumente të tjera, për të paraqitur prova dhe informacione të tjera, si dhe të drejtën për t’u dëgjuar për provat e paraqitura. Në analizë të akteve në fashikull dhe të parashtrimeve të sipërcituara të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit vëren se asnjë nga këto pretendime të subjektit nuk është i bazuar. Ky vlerësim mbështetet në faktet që vijnë:

12.1. Nga aktet në fashikull rezulton se në datën 17.01.2019 subjektit të rivlerësimit i është dërguar pyetësori standard, ndërsa me *e-mail*-in e datës 20.03.2019 i janë dërguar pyetjet shtesë. Subjekti i rivlerësimit me katër (4) *e-mail*-e, të dërguara në datën 27.03.2019, ka paraqitur përgjigjet e pyetjeve shtesë si dhe materialet përkatëse. Gjithashtu, me tre *e-mail*-e të datës 6.07.2019, në përgjigje të pyetësorit 3, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur nëntë (9) materiale shtesë. Për rrjedhojë, rezulton që Komisioni ka mbajtur komunikim të vazhdueshëm me subjektin, duke i dhënë atij mundësinë të paraqesë gjithë provat që ka konsideruar të nevojshme. Për të njëjtën arsye, nuk qëndron pretendimi i subjektit të rivlerësimit për mungesë bashkëpunimi apo mosrespektim të së drejtës për të paraqitur prova dhe informacione të tjera pasi një analizë e akteve në fashikull pasqyron një situatë faktike tejet të ndryshme nga ajo e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit. Konkretisht:

12.2. Për sa i përket njohjes me materialet e dosjes, rezulton se Komisioni ka njoftuar subjektin [me vendimin nr. 2, datë 18.9.2019], që të njihet me provat e administruara, si dhe të paraqesë pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja, lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Me *e-mail*-in e datës 23.09.2019, subjekti i rivlerësimit ka konfirmuar marrjen e materialeve nga Komisioni, lidhur me rezultatet e hetimit, si dhe ka kërkuar t’i vihet në dispozicion metodologjia e përdorur për analizën financiare, lidhur me shpenzimet e jetesës. Nëpërmjet *e-mail*-it të datës 25.09.2019, Komisioni i ka përcjellë metodologjinë e përdorur për llogaritjen e shpenzimeve, tabelën e detajuar për shpenzimet për udhëtimet, si dhe ka njoftuar për pranimin e kërkesës së subjektit për shtyrjen me 10 ditë të afatit për paraqitjen e përgjigjeve për rezultatet e hetimit nga subjekti. Në datën 17.10.2019, pas pranimit të kërkesës së dytë për shtyrje afati me 7 ditë të tjera, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur përgjigjet për rezultatet e hetimit, si dhe parashtrime dhe prova të reja.

⁴ Vendimi i arsyetuar i Komisionit iu njoftua subjektit të rivlerësimit në datën 21.01.2020. Ndaj vendimit të arsyetuar është ushtruar ankim nga subjekti i rivlerësimit, protokolluar me nr. {***} prot., datë 4.02.2020 dhe pranuar nga Komisioni me vendimin nr. 211/1, datë 05.02.2020.

12.3. Gjithashtu, nga aktet rezulton se në datën 20.09.2019, subjekti i rivlerësimit ka konfirmuar me shkrim se është njohur dhe ka marrë të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga ana e tij në format *CD*, nuk ka asnjë vërejtje në lidhje me dokumentacionin e tërhequr, si dhe se ky dokumentacion përputhet me dokumentacionin e dosjeve që i janë vënë në dispozicion fizikisht pranë Komisionit dhe inventarit përkatës. Ky fakt dëshmon që subjektit të rivlerësimit i është dhënë mundësia të njihet me materialet e dosjes.

12.4. Subjektit të rivlerësimit i është dhënë e drejta të paraqesë përgjigjet dhe provat lidhur me rezultatet e hetimit, sikurse dhe gjatë seancës dëgjimore të datës 11.11.2019, sipas procesverbalit ka pasur mundësinë të paraqesë argumentet në mbrojtje të tij. Siç referohet edhe më sipër, Komisioni ka pranuar kërkesat e subjektit për shtyrje të afatit në dy raste, duke dhënë dy shtesa të tilla për të mundësuar ushtrimin e të drejtave që lidhen me barrën e provës që nënkuptojnë edhe kohë shtesë për të mbledhur dhe paraqitur dokumente të nevojshme.

12.5. Së fundmi, nga aktet në fashikull nuk rezulton që subjekti të ketë parashtruar asnjë ankesë në lidhje me pamundësinë për të ushtruar këto të drejta. Këto pretendime rezultojnë të jenë ngritur për herë të parë në ankim dhe nuk përmbajnë shembuj ilustrues, të cilët do të zhbënin sa rezulton nga aktet.

- 13.** Sipas subjektit të rivlerësimit, vendimi i Komisionit për rrëzimin e disa kërkesave të tij për marrjen e provave është i paarsyetuar sipas nenit 49 të ligjit nr. 84/2016 dhe i paargumentuar për shkaqet e rrëzimit. Nga aktet e administruara rezulton se edhe ky pretendim i subjektit të rivlerësimit nuk pasqyron të vërtetën. Komisioni ka vendosur të pranojë të gjitha provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, duke i administruar ato në përputhje me nenin 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, si dhe të refuzojë kërkesat e subjektit të rivlerësimit për këqyrjen dhe kontrollin e sendeve të luajtshme dhe investimeve të kryera në apartamentin, në Golem dhe në apartamentin në rrugën “{***}”, si dhe për pyetjen e dy dëshmitarëve. Ky vendim, që mban nr. {***} dhe datë 28.10.2019, rezulton t’i jetë njoftuar subjektit me *e-mail*-in e datës 29.10.2019. Komisioni e ka bazuar vendimin për refuzimin e provave në pikat 6 dhe 7 të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, duke arsyetuar se e konsideron të panevojshme këqyrjen e dy apartamenteve, si dhe të panevojshëm dhe pa ndikim në marrjen e vendimit thirrjen e dy dëshmitarëve. Për rrjedhojë, edhe ky shkak ankimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar. Në kushtet kur subjekti nuk konteston ekzistencën e korrespondencës elektronike të sipërrefereuar apo pranimin e saj, pretendimi i tij për mungesë vendimmarrjeje nën dritën e nenit 49 të ligjit nr. 84/2016 nga ana e Komisionit, rezulton i pakuptimtë.
- 14.** Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se fakti që hetimi dhe gjykimi në Komision janë zhvilluar me pjesëmarrjen e relatorit dhe anëtarëve të trupit gjykues, bie në kundërshtim me nenin 6 të KEDNj, pasi një dublim i funksioneve mund të hedhë dyshime për paanshmërinë e këtyre anëtarëve, meqenëse nuk respekton parimin e ndarjes së funksioneve. Trupi gjykues i Kolegjit thekson se edhe ky pretendim i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar. Dispozitat ligjore që normojnë përbërjen e trupit gjykues të Komisionit prej tre anëtarësh, përfshirë edhe relatorin/en, si dhe detyrat e këtyre të fundit – përcaktuar në nenet 14 dhe 44 të ligjit nr. 84/2016 – janë trajtuar gjerësisht në vendime të mëparshme të Kolegjit⁵. Duke ritheksuar sa është arsyetuar gjerësisht nga Kolegji, përputhshmëria e veprimtarisë së institucioneve që kryejnë procesin e rivlerësimit me parimet e nenit 6 të KEDNj-së është certifikuar në fillim të procesit nga Komisioni i Venecias⁶, ka kaluar testin e kushtetutshmërisë nga Gjykata Kushtetuese⁷ dhe, së fundmi, është konfirmuar edhe nga shqyrtimi

⁵ *Shih, ndër të tjera, vendimin që lidhet me ankimin e subjektit të rivlerësimit I. M. [JR] 08/2021 në https://kpa.al/wp-content/uploads/2021/05/Vendimi_Idriz_Mulkurti_-2021.pdf.*

⁶ [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2016\)036-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2016)036-e).

⁷ http://www.gjk.gov.al/web/Vendime_përfundimtare_100_1.php paragrafët 38, 66 dhe 67 të vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017.

në praktikë nga GjEDNj-ja në vendimin që i përket Xhoxhaj kundër Shqipërisë. Pa riprodhuar sa është konstatuar dhe arsyetuar gjerësisht nga Kolegji në vendime të mëparshme përkundër këtij argumenti, trupi gjykues sjell në vëmendje sa vijon.

14.1. Pretendimi i subjektit për cenim të parimit të paanësisë dhe, për rrjedhojë, të procesit të rregullt ligjor, për shkak se të njëjtët anëtarë të trupit gjykues që bëjnë hetimin administrativ nuk mund të jenë të njëjtë me ata që bëjnë gjykimin dhe marrin vendimin përfundimtar, është i pabazuar. Referuar jurisprudencës së GjEDNj-së, ndër të tjera, në *Morel* kundër Francës, *Hauschildt* kundër Danimarkës etj., në kuptimin e nenit 6, paragrafi 1 i KEDNj-së, njohja e thelluar e dosjes nga gjyqtari nuk nënkupton një paragjykim që e pengon të konsiderohet si i paanshëm në momentin e gjykimit në themel dhe vlerësimi paraprak i të dhënave nuk mund të çojë në paragjykimin e vlerësimit përfundimtar⁸.

14.2. Në zbatim të parimeve mbi të cilat bazohet procesi i rivlerësimit – përfshirë barazinë përpara ligjit, kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë, proporcionalitetin dhe parime të tjera që shoqërojnë një proces të rregullt ligjor – ligjvënësi ka përcaktuar Kolegjin si të vetmen gjykatë të procesit që ka tagrat të kontrollojë dhe korrigjojë gabimet procedurale të konstatuara gjatë procesit të hetimit administrativ në Komision. Kjo rezulton edhe në qëndrimin e shprehur nga Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 2/201718, si dhe në opinionin e Komisionit të Venecias, sipas të cilave organet e procesit të rivlerësimit ofrojnë të gjitha garancitë e nevojshme për zhvillimin dhe respektimin e një procesi të rregullt ligjor. Konkretisht, sipas vendimit nr. 2, datë 18.01.2017, të Gjykatës Kushtetuese:

[...] 67. Për nga mënyra se si është konceptuar i gjithë sistemi i rivlerësimit në Kushtetutë, pra, organet që e kryejnë atë, mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të tyre dhe garancitë që ata gëzojnë, kompetencat që këto organe do të ushtrorjnë dhe baza ligjore ku mbështetet kjo veprimtari, vlerësohet se këto organe ofrojnë të gjitha garancitë që kërkon e drejta për një proces të rregullt gjyqësor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNj-së [...].

14.3. Të njëjtën linjë arsyetimi në funksion të zbatimit të të drejtave të procesit të rregullt rezulton të ketë mbajtur edhe GjEDNj-ja në vendimin që i përket Xhoxhaj kundër Shqipërisë. Në këtë vendim, GjEDNj-ja, ndër të tjera, është shprehur se:

307. [...] Konstatimet paraprake të bazuara në informacionin e disponueshëm, jo në përfitim të mbrojtjes së kërkueses, nuk mund të konsiderohet se sjellin në vetvete ndonjë paragjykim për rezultatin përfundimtar që do të merret pas parashtrimeve të argumenteve të kërkueses në seancë publike. Ajo që është e rëndësishme, është që vendimi përfundimtar të merret në bazë të të gjitha elementeve në dispozicion, përfshirë provat e paraqitura dhe argumentet e parashtruara në seancë (shih, për shembull, Hauschildt kundër Danimarkës, 24 maj 1989, paragrafi 50, Seria Nr. 154, dhe Morel kundër Francës, nr. 34130/96, paragrafi 45, Gjykata 2000-VI).

308. Prandaj, nuk ka asnjë ngatërresë mes detyrimit ligjor të KPK-së për të hapur hetimin, në të cilin nuk u bënë akuza ose konstatime të shkeljeve disiplinore të kërkueses dhe detyrës së tij për të marrë një vendim në lidhje me përgjegjësinë disiplinore të kërkueses. Një rregullim i tillë procedural nuk është i pazakontë në proceset disiplinore apo procese të tjera administrative në sistemet ligjore evropiane. Sipas këndvështrimit të gjykatës, vetëm fakti i thjeshtë që KPK-ja konstatoi gjetje paraprake në çështjen e kërkueses, nuk është i mjaftueshëm për të nxitur ndonjë frikë të justifikuar objektivisht në lidhje me paanësinë e KPK-së dhe detyrës së tij për të marrë një vendim në lidhje

⁸ Paragrafët 142 – 163 të Udhëzuesit mbi nenin 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut – E drejta për një proces të rregullt (aspekti civil). https://www.echr.coe.int/Documents/Guide_Art_6_SQL.pdf.

me përgjegjësinë disiplinore të kërkuases. Një rregullim i tillë procedural nuk është i pazakontë në proceset disiplinore apo procese të tjera administrative në sistemet ligjore evropiane. Sipas këndvështrimit të gjykatës, vetëm fakti i thjeshtë që KPK-ja konstatoi gjetje paraprake në çështjen e kërkuases, nuk është i mjaftueshëm për të nxitur ndonjë frikë të justifikuar objektivisht në lidhje me paanësinë e KPK-së.

14.4. Për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit thekson se në kushtet kur mënyra e funksionimit të institucioneve të rivlerësimit u është nënshtruar filtrave të analizës së kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, nga njëra anë, si dhe faktit që përpos kompetencës që Kushtetuta dhe ligji kanë përcaktuar për Komisionin, në funksion të garantimit në praktikë të zgjidhjes ligjore, ligjvënësi ka përcaktuar Kolegjin si e vetmja gjykatë e procesit që ka tagrat të kontrollojë dhe të korrigjojë gjithë gabimet procedurale të konstatuara gjatë procesit të hetimit administrativ në Komision, pretendimi i subjektit të rivlerësimit nuk gjendet i mbështetur në ligj dhe, për rrjedhojë, nuk qëndron.

15. Subjekti i rivlerësimit parashtron, po ashtu në ankim se trupi gjykues i Komisionit që ka gjykuar çështjen e tij nuk është krijuar, sipas pikës 1 të nenit C të Aneksit të Kushtetutës, pasi nuk rezulton të jetë një trup gjykues i përhershëm. Sipas subjektit të rivlerësimit, anëtarëve të Komisionit u mungon profesionalizmi dhe përvoja për të trajtuar çështjet komplekse në themel të procesit të *vetting*-ut dhe asnjë prej tyre nuk ka përvojën e nevojshme juridike dhe/ose gjyqësore dhe aftësi për gjykimin e çështjeve. Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se edhe ky pretendim i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar. Nga aktet në fashikull rezulton se trupi gjykues dhe relatori i çështjes në Komision janë caktuar në respektim të parashikimeve të pikës 2, të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe të Rregullores “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”.

15.1. Sa i përket pretendimit për përvojën dhe aftësinë për gjykimin e çështjeve, trupi gjykues i Kolegjit çmon të sjellë në vëmendje, sërish vendimin e GJEDNJ-së në çështjen Xhoxhaj kundër Shqipërisë dhe jurisprudencën e Kolegjit në interpretim të dispozitave ligjore që rregullojnë kriteret dhe mënyrën e funksionimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimi. Konkretisht, në paragrafët 300, 288 dhe 282, përkatësisht GJEDNJ⁹ arsyeton:

“[...] Sipas këndvështrimit të gjykatës, fakti që anëtarët e KPK-së nuk vinin nga radhët e gjyqtarëve profesionistë në detyrë, ishte në përputhje me frymën dhe qëllimin e procesit të rivlerësimit, domethënë për të shmangur çdo konflikt individual interesi dhe për të siguruar besimin e publikut në këtë proces. Gjykata u referohet më tej kërkesave të rrepta të përzgjedhjes që anëtarët e KPK-së pritej të përmbushnin (shih paragrafin 123 më lart). Ajo vëren se këto anëtarë u përzgjodhën nga Parlamenti në përputhje me procedurën e përcaktuar me ligj (shih paragrafin 124 më lart) [...]”

[...] Gjykata arrin në përfundimin se, duke pasur parasysh faktin, se si KPK-ja, ashtu dhe KPA-ja ishin krijuar dhe formuar në një mënyrë legjitime, duke përmbushur kërkesat e një “gjykatë të krijuar me ligj”, kërkuësja i ishte adresuar ‘gjykatës’, sipas kuptimit të kushtit të parë të testit Vilho Eskelinen. Për këtë arsye, neni 6/1 i Konventës gjen zbatim nën aspektin civil të saj [...]

[...] Gjykata, më tej, përsërit se një organ, i cili nuk është klasifikuar si një nga gjykatat e vendit, për qëllimet e nenit 6/1, mund të klasifikohet brenda konceptit të një ‘gjykatë’, në kuptimin material të kësaj shprehjeje. Sipas praktikës gjyqësore të vendosur të gjykatës, një ‘gjykatë’ karakterizohet në atë kuptim thelbësor të termit nga funksioni i saj gjyqësor, që do të thotë, të vendosë për çështjet brenda kompetencës së saj në bazë të rregullimeve ligjore dhe pas procedurave të zhvilluara në një mënyrë të

⁹ Shih [https://hudoc.echr.coe.int/fre#{%22itemid%22:\[%22001208053%22\]}:~:text=https%3A/hudoc.echr.coe.int/fre%3F%3D001%2D208053](https://hudoc.echr.coe.int/fre#{%22itemid%22:[%22001208053%22]}:~:text=https%3A/hudoc.echr.coe.int/fre%3F%3D001%2D208053).

përcaktuar. Ajo, gjithashtu, duhet të përmbushë një sërë kushtesh të mëtejshme, 'të tilla si pavarësia, në veçanti nga pushteti ekzekutiv, paanësia, kohëzgjatja e mandatit të anëtarëve të saj [...]', (shih Guðmundur Andri Ástráðsson, cituar më lart, paragrafi 219, dhe referenca cituar aty). Fuqia e vendimit buron nga vetë nocioni i 'gjykatës' (shih, Mutu dhe Pechstein k. Zvicrës, nr. 40575/10 dhe 67474/10, paragrafi 139, 2 tetor 2018, dhe referencat e cituara në të)''.

15.2. Në përmbledhje të sa më sipër, në linjë edhe me jurisprudencën e mëparshme të Kolegjit, trupi gjykues rithekson që mënyra e funksionimit të institucioneve të rivlerësimit, rregulluar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016, është konstatuar të jetë në përmbushje të garancive procedurale kushtetuese për procesin e rregullt. Për këto arsye, pretendimet e subjektit të rivlerësimit që lidhen me mënyrën e funksionimit të Komisionit janë të pabazuara.

16. Subjekti i rivlerësimit pretendon se vlerësimi përfundimtar i Komisionit, bazuar vetëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë, përbën një shkelje të rëndë të nenit 6 të KEDNJ, të pikës 1, të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Sipas subjektit të rivlerësimit, Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 e detyrojnë Komisionin të kryejë procesin e rivlerësimit, bazuar në vlerësimin e përgjithshëm të tri kritereve në mënyrë të domosdoshme.

16.1. Duke vlerësuar edhe këtë pretendim të pabazuar në ligj, trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje së pari se dispozita e referuar nga vetë subjekti i rivlerësimit, qartazi përcakton tagrën e Komisionit dhe Kolegjit që vendimet t'i marrin mbi një ose disa kritere. Konkretisht, neni 4 pika 2 përcakton që vendimi përfundimtar nga institucionet e rivlerësimit "[...] merret bazuar në një ose disa prej kritereve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kritereve ose në vlerësimin tërësor të procedurave [...]".

16.2. Ky përcaktim i qartë ligjor dhe frymë e ligjit gjendet edhe në parimin e përcaktuar nga ligjvënësi, sipas të cilit për konfirmimin në detyrë nevojitet kalimi me sukses i të tria kritereve të rivlerësimit në nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016¹⁰. Mbi bazën e këtyre premisave është kryer edhe procesi i rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit, z. Arian Balliu dhe mbi të njëjtën bazë ligjore, Kolegji ka arsyetuar gjerësisht në çështje të mëparshme¹¹ mbi bazën e ankimeve, duke mbërritur në konkluzione mbi bazën edhe të një kriteri të rivlerësimit të pasurisë. Në këto kushte, edhe ky pretendim i subjektit të rivlerësimit gjendet i pabazuar.

17. Subjekti i rivlerësimit pretendon, më tej, se Komisioni nuk ka pranuar provat që justifikojnë në mënyrë ezaures burimet e ligjshme të pasurive, duke mos përmbushur detyrimin kushtetues të organeve të rivlerësimit që të kryejnë veprime për të konfirmuar vërtetësinë dhe saktësinë e deklarimeve të subjekteve në procesin e rivlerësimit.

17.1. Nga analiza e akteve pjesë e fashikullit, trupi gjykues i Kolegjit vëren se ndryshe nga sa pretendon subjekti, Komisioni rezulton të ketë marrë në analizë jo vetëm deklaratat dhe provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI gjatë procesit të rivlerësimit dhe, ndër vite, por edhe provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, si dhe shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituara nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit. Përpos këtyre akteve,

¹⁰ Neni 59 pika 1 e ligjit nr. 84/2016 parashikon: "1. Konfirmimi në detyrë i jepet subjektit të rivlerësimit në rast se plotësohen së bashku kushtet e mëposhtme: (a) kur arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë; (b) kur arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës; (c) kur arrin një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale. 2. Parashikimi i paragrafit të mësipërm nuk zbatohet për rastin e parashikuar në nenin 61, pika 5, të këtij ligji [...]".

¹¹ Ndër të tjera, pasqyruar në vendimet e Kolegjit, që lidhen me subjektin e rivlerësimit A. Xh. [nr. 9/2018 (JR)], paragrafi 44; vendimi që lidhet me subjektin e rivlerësimit D. Rr. [nr. 15/2019 (JR)], paragrafi 119, vendimi që lidhet me subjektin e rivlerësimit T. N. [nr. 11/2018 (JR)], paragrafi 5, vendimi që lidhet me subjektin e rivlerësimit A. Z. [nr. 2/2019 (JR)], paragrafi nr. 35.2.

Komisioni ka administruar edhe raportet përkatëse për dy kriteret e tjera të rivlerësimit, atë të kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja dhe raportin e aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Po ashtu, trupi gjykues i Kolegjit vëren edhe që Komisioni ka vendosur¹² të pranojë disa nga provat, si dhe të refuzojë disa nga kërkesat e subjektit të rivlerësimit për këqyrjen dhe kontrollin e sendeve të luajtshme, si dhe për pyetjen e dy dëshmitarëve. Së fundmi, siç rezulton nga procesverbalet në fashikullin e Komisionit, subjekti ka pasur mundësinë gjatë seancës dëgjimore dhe është shprehur lidhur me gjetjet e Komisionit, sikurse edhe ka paraqitur provat që ka konsideruar të nevojshme për mbrojtjen e tij.

17.2. Nga sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit konkludon se Komisioni ka kryer procesin e shqyrtimit dhe të vlerësimit të provave, në të gjitha fazat e procesit të rivlerësimit dhe është shprehur për to në vendimin përfundimtar. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit se Komisioni nuk ka vepruar për të hetuar dhe vlerësuar gjithë faktet e nevojshme për procedurën e rivlerësimit është i pabazuar.

18. Trupi gjykues i Kolegjit konstaton që është i pabazuar edhe pretendimi i subjektit të rivlerësimit që Komisioni ka dhënë një njoftim kundërshtues, meqenëse kryesuesja e trupit gjykues në seancën e datës 11.11.2019 u shpreh për shtyrjen e seancës për në datën 18.11.2019, për të vlerësuar provat dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, ndërkohë që në datën 12.11.2019 ka nxjerrë njoftimin se në datën 18.11.2019 do të shpallej vendimi. Nga aktet në fashikull, konkretisht, nga procesverbali i seancës dëgjimore të datës 11.11.2019, rezulton se në mbyllje të seancës, kryesuesja Xh. P., pasi është dëgjuar subjekti i rivlerësimit për qëndrimin përfundimtar, ka deklaruar: *“Trupa gjykuese tërhiqet për vendim. Seanca do të rifillojë në datën 18.11.2019, në orën 9:30, në këtë sallë.”* Qartazi, subjekti i rivlerësimit është njoftuar për hapin procedural që pritej pas kësaj seance – trupa po tërhiqej për të marrë vendim – dhe që seanca e radhës do t’i dedikohet shpalljes së vendimit në datën 18 nëntor. Bisedimet për vendimmarrjen nga trupi gjykues janë zhvilluar në datën 13.11.2019, dhe në datën 18.11.2019, në seancë dëgjimore është shpallur vendimi për subjektin e rivlerësimit, pa praninë e tij, megjithëse kishte marrë dijeni. Në këto rrethana faktike, argumentet e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit për mungesë informacioni apo kontradikta në njoftimet e Komisionit duket tejet i pakuptimtë e alogjik. Komisioni ka kryer veprimet e duhura procedurale për zhvillimin e seancës dëgjimore dhe shpalljen e vendimit, sipas parashikimeve të nenit 55, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit vendimi shpallet në fund të seancës dëgjimore. Shpallja e vendimit pa pjesëmarrjen e subjektit të rivlerësimit, në kushtet kur nga procesverbali rezulton se ai kishte dijeni për ditën dhe orën e zhvillimit të seancës për shpalljen e vendimit, rezulton po ashtu të ketë qenë një zgjedhje e tij.
19. Subjekti i rivlerësimit parashtron se Komisioni i ka kaluar një barrë prove tej mundësive objektive për paraqitjen e provave shkresore, të cilat nuk gjenden as në institucionet shtetërore dhe janë jashtë afatit ligjor të ruajtjes së tyre. Komisioni, sipas subjektit të rivlerësimit, nuk ka komunikuar saktë dhe qartë rrethanat që prodhojnë prezumimin ligjor në favor të masës disiplinore. Nga analiza e akteve në fashikull rezulton që ky pretendim i subjektit të rivlerësimit, po ashtu është i pabazuar. Në përfundim të hetimit, Komisioni është shprehur për çdo gjetje, për të cilat rezulton t’i ketë kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera, për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016. Nga dispozitat e ligjit nr. 84/2016, me fokus nenin 52, pika 2 dhe praktikën e ndjekur nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, momenti procedural, kur subjekti njihet me tërësinë e provave të mbledhura, rezultatet e pritshme, për t’i kundërshtuar më pas, në funksion të barrës për të provuar të kundërtën, është njoftimi i rezultateve të hetimit administrativ. Nga aktet në fashikull rezulton se pas njohjes¹³ me dosjen dhe rezultatet e

¹² Me vendimin nr. 4, datë 28.10.2019, njoftuar subjektit me e-mail-in e datës 29.10.2019.

¹³ Subjekti i rivlerësimit në datën 20.09.2019, ka deklaruar se është njohur dhe ka marrë të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga ana e tij në CD. Me e-mail-in e datës 04.11.2019 subjekti i është drejtuar Komisionit me kërkesën për t’u njohur me relacionet e këshilltarit ekonomik dhe të këshilltarit juridik. Komisioni me e-mail-in e datës

hetimit, subjekti ka paraqitur shpjegimet dhe provat që ai i ka konsideruar të nevojshme, sikurse edhe prapësimet. Këto rrethana dëshmojnë se subjekti i rivlerësimit ka qenë i njohur me gjetjet dhe rrethanat për të cilat i ka kaluar barra e provës. Për këto arsye, edhe ky shkak ankim rezultoi i pabazuar.

20. Subjekti parashtron në ankim se Komisioni është bazuar vetëm në të dhënat dhe provat e aktit përfundimtar të kontrollit të pasurisë të ILDKPKI-së, i cili nuk duhej të merrej në konsideratë nga Komisioni, si një akt absolutisht i pavlefshëm që nuk mund të sjellë asnjë pasojë juridike. Ky akt kontrolli, sipas subjektit të rivlerësimit, është absolutisht i pavlefshëm, pasi është depozituar në Komision përtej afatit ligjor prej *jo më vonë se 180 ditë nga dita e depozitimit të deklaratës së pasurisë nga subjekti i vlerësimit*, të parashikuar në pikën 4, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje që edhe ky pretendim i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar në ligj dhe në rrethanat faktike që rezultojnë nga aktet në fashikull.

20.1. Së pari, nga përmbajtja e akteve në fashikull, rezultoi se Komisioni në vendimin e tij nuk është bazuar vetëm në të dhënat dhe provat e paraqitura në Raportin e ILDKPKI-së, por edhe në provat e administruara gjatë hetimit, përgjigjet e subjektit në pyetësorë, parashtrimet, si dhe në provat e depozituara në funksion të barrës së provës. Siç është argumentuar më sipër, [në paragrafin 17.1], në lidhje me aktet e marra në konsideratë nga Komisioni në funksion të vendimmarrjes, vendimi është bazuar në një sërë deklaratash të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, ndër vite, akte të administruara në funksion të hetimit administrativ nën dritën e nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, shpjegimet me shkrim të përcjella nga subjekti i rivlerësimit gjatë procesit etj. Në këto kushte, ky pretendim nuk qëndron.

20.2. Së dyti, nga përmbajtja e nenit 108/ç të Kodit të Procedurave Administrative, rezultoi që vonesa në dorëzimin e një akti nuk është parashikuar si një nga rastet që passjellin pavlefshmërinë e aktit administrativ¹⁴, pasi nuk përbën një shkelje thelbësore të ligjit lidhur me kompetencën e organit publik, procedurën e nxjerrjes së tij apo formës dhe elementë të tjerë të detyrueshëm. Nga dispozita e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, rezultoi që afati 180 ditë është një afat orientues, me synim strukturimin e procesit të rivlerësimit që kryen Komisioni dhe për të lejuar këtë të fundit fillimin e punës në një kohë sa më të afërt me atë të hyrjes në fuqi të ligjit. Kryerja e kontrollit dhe dërgimi i raportit që i përket subjektit të rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, pas afatit 180-ditor duke nisur nga data e plotësimit të deklaratës së pasurisë prej tij, nuk rezultoi të ketë ndikuar në përmbajtjen e këtij akti, peshën në vlerësimin tërësor të procesit të kontrollit të pasurisë, ushtrimin e ndonjë të drejte që gëzon subjekti në proces, përpos faktit që nuk rezultoi të ketë kushtëzuar hetimin administrativ të kryer nga Komisioni në ndonjë mënyrë apo aspekt. Përkundrazi, nga aktet në fashikull rezultoi se shorti për rivlerësimin e subjektit është hedhur në Komision në datën 18.09.2018¹⁵, shtatë (7) muaj pasi ishte përcjellë raporti i kontrollit të kryer nga ILDKPKI-ja, në shkurt 2018¹⁶. Ndërkohë, vendimi përfundimtar për subjektin nga Komisioni është marrë 14 muaj pasi është hedhur shorti, 10 muaj pasi ai mori pyetësorin standard nga Komisioni. Nuk rezultoi që subjekti të ketë parashtruar kundërshtime për faktin që hetimi administrativ ka zgjatur për të, për më shumë se një vit, përkundrazi. Subjekti ka kërkuar dhe ka përfituar dy herë zgjatje afati – referuar më sipër në paragrafin 12.2 – sikurse edhe nuk ka ngritur kundërshtime për shkak se hetimi i tij administrativ ka

05.11.2019, ka njoftuar subjektin e rivlerësimit se relacionet nuk mund t'i vihen në dispozicion pasi janë dokumente të brendshme të Komisionit.

¹⁴ Neni 108/ç parashikon: “Akti administrativ është absolutisht i pavlefshëm në rastet e mëposhtme: (a) kur vjen në kundërshtim të hapur dhe flagrant me një dispozitë urdhëruese të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi lidhur me: (i) kompetencën e organit publik; (ii) procedurën e nxjerrjes së tij; ose (iii) formën ose elementë të tjerë të detyrueshëm të aktit; (b) është nxjerrë nëpërmjet mashtrimit, kanosjes, mitmarrjes, konfliktit të interesit, falsifikimit apo një veprimi tjetër që përbën vepër penale; (c) ekzekutimi i aktit mund të shkaktojë një veprim të dënueshëm, sipas legjislacionit penal; (ç) në çdo rast tjetër të parashikuar shprehimisht në ligj”.

¹⁵ Shpallur në <https://kpk.al/njoftim-59/>.

¹⁶ Referuar në poshtëshënimin nr. 1.

nisur katër (4) muaj pasi ishte hedhur shorti për të, që përkonin me dy vjet pasi ai ka plotësuar deklaratën e pasurisë dhe ka zgjatur, më së paku, nga janari deri në nëntor 2019.

20.3. Në përmbledhje të sa më sipër, një analizë rigoroze e kronologjisë së procesit të rivlerësimit të subjektit, në përgjigje të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, tregon se ky pretendim i subjektit është selektiv, ka për objekt konkluzionet e kontrollit dhe në thelb përbën një përpjekje për të anashkaluar sa ka rezultuar nga procesi i kryer për kriterin e kontrollit të pasurisë nga Komisioni, në rastin e tij në tërësi, nëpërmjet argumenteve jo përcaktuese dhe jo relevante në funksion të shqyrtimit të vendimit objekt shqyrtimi.

- 21.** Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka vepruar në kundërshtim me nenin 61 të ligjit nr. 84/2016, në kushtet kur nuk gjendet në kushtet e deklaratimit të më shumë se dyfishit të pasurisë së ligjshme, parashikuar nga pika 1 e kësaj dispozite. Sipas subjektit të rivlerësimit edhe në rast se sikur të pranohej se për të ardhurat nuk janë paguar detyrimet tatimore, ato duhen parë në raport me të ardhurat totale të subjektit për të konkluduar, nëse subjekti gjendet ose jo në kushtet e ndëshkueshmërisë, sipas nenit D, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues i Kolegjit konstaton që edhe ky pretendim i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar në ligj, siç shtjellohet në vijim dhe pasqyruar në vendime të mëparshme të Kolegjit në mënyrë konsistente.

21.1. Së pari, trupi gjykues i Kolegjit vëren se vendimi për shkarkimin e subjektit është marrë pasi është konstatuar se ai nuk *ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive të tij dhe personave të lidhur, në kuptim të nenin D të Aneksit të Kushtetutës* dhe, si rrjedhojë, është në kushtet e parashikuara në pikën 3, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, lexuar së bashku me nenin 33 të po këtij ligji, për deklarim të pamjaftueshëm të pasurisë. Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit është gjetur në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme për disa pasuri, ka kryer deklarim të rremë dhe të pasaktë, si dhe është gjendur në situatën e konfliktit të interesit. Me fjalë të tjera, masa disiplinore e shkarkimit nga detyra për subjektin e rivlerësimit ka ardhur në zbatim të përcaktimeve të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, për deklarim të pamjaftueshëm. Ndërsa është e saktë që subjekti nuk gjendet në kushtet e deklarimit të dyfishit të pasurisë së ligjshme, trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje që asgjë në gjuhën dhe konceptin e pesë paragrafëve përbërës të kësaj dispozite nuk sugjeron se ato përbëjnë kritere të cilat duhet të përmbushën në mënyrë kumulative. Përkundrazi, situatat ligjore të cilat passjellin shkarkimin nga detyra, sipas nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, janë situata ligjore autonome. Pika 1 – situata e dyfishit të pasurisë së ligjshme – është vetëm një prej tyre¹⁷. Nga leximi i dispozitës, nën dritën e parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, rezulton qartë që mjafton të gjendet e plotësuar një prej kushteve të parashikuara në njërin prej pikave për të passjellë dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

21.2. Për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit e çmon si të pabazuar pretendimin e subjektit se dhënia e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra kushtëzohet nga deklarimi i më shumë se dyfishit të pasurisë së ligjshme. Deklarimi i pamjaftueshëm i pasurisë është shtjelluar në përcaktimet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, zberthehet në nenet 30-33 të ligjit nr. 84/2016, të cilat përcaktojnë parimet dhe mënyrën e verifikimit të përmbushjes së detyrimeve të subjektit të rivlerësimit për të kryer

¹⁷ Neni 61 i ligjit nr. 84/2016 parashikon: “Shkarkimi nga detyra i subjektit të rivlerësimit jepet si masë disiplinore në këto raste: 1. Kur rezulton se ka deklaruar më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme gjatë vlerësimit të pasurisë, përfshirë edhe personat e lidhur me të. 2. Kur rezulton me probleme serioze gjatë kontrollit të figurës, sepse ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar që bën të pamundur vazhdimin e detyrës. 3. Kur rezulton se ka bërë deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës dhe pasurisë, sipas parashikimeve të neneve 39 dhe 33 të këtij ligji. 4. Kur rezulton si i papërshtatshëm nga vlerësimi i aftësive profesionale. 5. Në rast se nga vlerësimi tërësor, në kuptim të nenit 4, pika 2, të këtij ligji, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit.”

deklarim të saktë dhe sanksionohet në nenin 61 në pikat që rregullojnë kontrollin e pasurisë. Në këtë kuadër dhe pa përsëritur sa është arsyetuar gjerësisht në interpretim të këtyre normave në jurisprudencën e Kolegjit¹⁸, trupi gjykues i Kolegjit çmon vetëm të sjellë në vëmendje sa rezulton nga leximi logjik i dispozitave: legjislatori ka zgjedhur formulimin alternativ, duke u dhënë të njëjtën peshë shkeljeve për shkaqe të veçanta. Vërtetimi i secilit prej këtyre shkaqeve autonome, sipas Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit, shkon në favor të prezumimit të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Kjo do të thotë se subjektet e rivlerësimit duhet të shpjegojnë bindshëm se nuk gjenden në kushtet e dyfishit të pasurisë së ligjshme, nuk kanë kontakte të papërshtatshme, nuk kanë kryer deklarim të pamjaftueshëm të vlerësimit të pasurisë, nuk kanë kryer deklarim të pamjaftueshëm të kontrollit të figurës, janë të aftë profesionalisht dhe që me sjelljet dhe veprimet e tyre nuk kanë cenuar besimin e publikut të drejtësia. Për rrjedhojë, shkeljet e dispozitave që lidhen me deklarimin e pamjaftueshëm të pasurisë sipas ligjit kanë të njëjtën peshë, sikurse shkeljet për kriteret e tjera të parashikuara në nenin 61 të ligjit nr. 84/2016. Për këto arsye, ky pretendim i subjektit është i pabazuar.

22. Së fundmi, subjekti i rivlerësimit kërkon që të kryhet edhe vlerësimi për kontrollin e figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale. Siç arsyetohet më sipër në paragrafin 16, ky kërkim i subjektit që kushtëzon vendimmarrjen edhe në kryerjen e kontrollit të dy kriterëve të tjera, në kushtet kur Komisioni ka arritur në vendim bazuar në një kriter të vetëm, është i pabazuar në ligj. Nga aktet në fashikull rezulton që Komisioni ka administruar raportet nga KLGJ-ja dhe nga DSIK-ja në lidhje me vlerësimet e aftësive profesionale dhe të figurës së subjektit të rivlerësimit. Në përfundim të hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni, trupi gjykues vendosi të mbyllë hetimin për subjektin e rivlerësimit, z. Arjan Balliu, mbështetur në gjetjet e konstatuara për një nga tri kriteret e vlerësimit, atë të vlerësimit të pasurisë. Ky vendim mbështetet në nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, sipas së cilës rivlerësimi mund të kryhet edhe mbi bazën e një kriteri. Konfirmimi në detyrë kërkon plotësimin me sukses të kontrollit në të tria kriteret, ndërsa moskalimi me sukses, qoftë edhe të njërit prej kriterëve, është shkak për dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Në përmbledhje, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se kërkesa e subjektit të rivlerësimit për kryerjen e vlerësimit edhe për dy kriteret e tjera, për sa kohë që ai nuk sjell asnjë argument dhe provë shtesë në drejtim të kësaj kërkesë, është i panevojshëm. Nën dritën e nevojës për efikasitet në procesin e rivlerësimit, në kushtet kur kontrolli i kriterëve të tjera nuk do të sillte asnjë ndikim në zgjidhjen përfundimtare të çështjes, hetimi i tyre do të përbënte një tej zgjatje të pajustificueshme të procesit.

C. Mbi shkaqet e ankimit për vlerësimin e pasurisë

23. Trupi gjykues i Kolegjit analizoi dhe vlerësoi shkaqet e ankimit të ngritura nga subjekti i rivlerësimit, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, si kriter i vetëm mbi të cilin, në zbatim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka marrë vendimin për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Arjan Balliu.

I. *Për apartamentin 1+1+aneks, me sipërfaqe 70, 8 m² dhe garazh me sipërfaqe 12,5 m², të ndodhur në rrugën “{***}”, pall. {***}, shk. {***}, ap. {***}, Tiranë*

24. Për këtë pasuri, Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit është në: (i) kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të rremë lidhur me burimin e krijimit; (ii) subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e saj; (iii) subjekti ka bërë kontratë fiktive për shitjen e kësaj pasurie vjehrrës, e cila ka rezultuar në mungesë të burimeve të

¹⁸ Shih, ndër të tjera, paragrafët 22.15 të vendimit të Kolegjit, që i përket subjektit të rivlerësimit Xh. Z. [JR 19.2019] në https://kpa.al/wp-content/uploads/2019/10/Vendimi-Xh_Zaganjori-i-anonimizuar-perfshire-mendimin-paralel.pdf, paragrafin 21.2 të vendimit të Kolegjit që i përket subjektit të rivlerësimit I. M. [JR nr.22/2021], https://kpa.al/wpcontent/uploads/2021/11/Vendimi_Illir_Mustafaj_pëfshirë_mendim_pakice_anoni_mizuar-converted.pdf.

ligjshme financiare për blerjen e pasurisë; (iv) subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën *vetting* apartamentin tjetër (pasuri në pronësi të babait), në të njëjtën adresë, që ka në përdorim dhe zotërim që nga viti 2012 dhe ka kryer fshehje të kësaj pasurie; si dhe (v) nuk arriti të provojë bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie.

24.1. Subjekti i rivlerësimit kundërshton vendimin e Komisionit, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur sa vijon:

a. Deklarimi i shumës 15.000 USD, si burim krijimi i kësaj pasurie në deklaratën periodike për vitin 2003, ka qenë një lapsus, nisur nga fakti se këto kanë qenë deklaratimet e para dhe për shkak të *mosinformimit* nga ILDKPKI-ja. Ky fakt, dëshmohet nga deklarata noteriale e vitit 2015, e lëshuar nga vjehrra e tij, znj. L. V., përpara ligjit nr. 84/2016 dhe procesit të rivlerësimit. Burim krijimi i kësaj pasurie kanë qenë kursimet familjare dhe të ardhurat nga pagat e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes në vitet 1991-2001 dhe vlera monetare prej një (1) milion lekë rrjedh nga puna e babait si emigrant në Greqi.

b. Komisioni nuk ka marrë në konsideratë të ardhurat e bashkëshortes për vitet 1999-2000 dhe për vitin 2001, ka aplikuar kurs këmbimi Lekë-USD të pafavorshëm për periudhën 1991-2001 dhe së fundmi, që metodologjia e përlogaritjes së shpenzimeve të jetesës nga Komisioni është arbitrare, e shifrat sipas tij *diskriminuese dhe jashtë çdo lloj logjike ekonomike dhe jetësore*, meqenëse janë përfshirë shpenzime jetese për gjithë vitin për fëmijën e tij të lindur në prill të vitit 2000.

c. Kontrata e shitjes së apartamentit vjehrrës, në vitin 2012, në vlerën 8.800.000 lekë, është bërë në përputhje me ligjin dhe për të janë shlyer edhe detyrimet tatimore, me një vlerë reale pasurie pas rivlerësimit të pronës. Detyrimi për kryerjen e transaksioneve nëpërmjet sistemit bankar është vendosur në vitin 2013. Të ardhurat e krijuara nga vjehrra dhe vjehrra për blerjen e kësaj pasurie provohen nga kontratat e qirasë për pasuritë në pronësi të tyre për periudhën 2003-2012. Shuma e përfituar nga shitja e apartamentit është deklaruar në deklaratën periodike për vitin 2012, por deklarimi i gjendjes *cash* si pjesë e deklarimit periodik është vendosur vetëm pas miratimit të ligjit nr. 45/2014.

ç. Detyrimi i deklarimit të përdorimit të pasurisë në pronësi të babait është ezauruar nëpërmjet deklarimit si vendbanim në rubrikën që i përket të dhënave personale, në deklaratën *vetting*. Kjo pasuri nuk e bën babain person tjetër të lidhur në kuptim të nenit 13, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Së fundmi, babai ka pasur të ardhura të konsiderueshme nga emigracioni, për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie.

24.2. Pasi analizoi vendimin objekt shqyrtimi, aktet në fashikull dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit në ankim, trupi gjykues i Kolegjtit arrin në përfundimin se ky shkak ankimi është i pabazuar. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit bien ndesh me deklaratimet e tij në deklaratë e pasurisë *vetting*, për sa i përket burimit të krijimit të kësaj pasurie analizuar edhe përkundër deklaratimeve të tij periodike vjetore ndër vite. Subjekti gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie. Arsyetimi për secilin aspekt të ankimit shtjellohet në vijim.

I/A. Për burimet e krijimit të pasurisë

24.2.1. Në deklaratën e vitit 2003, subjekti ka deklaruar si burim për blerjen e apartamentit në vitin 2001, në vlerën 28.000 USD, kursimet e tij dhe të bashkëshortes, si dhe vlerën 15.000 USD dhuratë nga vjehrra. I njëjti specifikim pasqyrohet edhe në deklaratën e atij viti të kryer nga bashkëshortja e subjektit, si person i lidhur. Përkundër deklaratës së vitit 2003, në deklaratën *vetting*, subjekti dhe bashkëshortja kanë deklaruar se burim krijimi i apartamentit ka qenë *të ardhura nga paga dhe kursimet e prindërve*, me pjesë takuese 100% – sipas deklarimit të subjektit të rivlerësimit.

24.2.2. Në ankim, subjekti parashtron se mospërputhjet mes burimeve të deklaruara kanë qenë një gabim i tij në vitin 2003, për shkak të mungesës së përvojës dhe *mosinformimit* nga ILDKPKI-ja. Në deklaratimet e tij në Komision, gjatë barrës së provës, subjekti ka pretenduar se shuma 15.000 USD nuk ka shërbyer si burim për krijimin e pasurisë apartament, por i është dhënë në *cash* bashkëshortes në vitet 2002-2004. Si dokument provues për dhënien e dhuratës 15.000 USD nga vjehri, subjekti ka paraqitur në Komision deklaratën noteriale të datës 09.01.2015 të vjehrrës, znj. L. V.. Në atë deklaratë, znj. L. V. ka deklaruar se bashkëshorti i ka falur vajzës një pjesë të të ardhurave të tyre nga qiratë e pronave, në shumën 15.000 USD, rreth viteve 2002-2004, për të blerë një banesë në Tiranë. Nga përmbajtja e kësaj deklarate, rezulton se shuma është deklaruar me destinacion apartamentin në Tiranë, fakt që bie ndesh me pretendimin e subjektit se shumën në fjalë [15 000 USD] nuk e ka përdorur për blerjen e apartamentit. Po ashtu, në kushtet kur apartamenti është blerë në vitin 2001, ky deklarim i znj. L. V. bie ndesh me kronologjinë kohore të blerjes së apartamentit – kjo pasuri është blerë me kontratën nr. {***}, datë 16.07.2001, kohë përpara harkut kohor 2002-2004 të përcaktuar prej saj si periudhë gjatë së cilës është dhuruar shuma. Subjekti nuk ka provuar në asnjë gjurmë dokumentare marrjen e kësaj shume qoftë në vitin 2001 – nëse ndiqet kronologjia kohore e deklaruar në vitin 2003 – qoftë në periudhën kohore të mëpasme – nëse pranohet kronologjia e pretenduar prej tij në procesin e rivlerësimit. Së fundmi, nëse ky dhurim do të kishte ndodhur në periudhën kohore të treguar [2002-2004], do të kishte qenë pjesë e deklaratës para fillimit të detyrës nga bashkëshortja për vitin 2004, kryer në mars 2005 dhe jo pasqyruar në mars 2004 si e ardhur që ka shërbyer si burim për shtëpinë e blerë në korrik 2001. Për shkak të gjithë këtyre mospërputhjeve, pretendimet e subjektit të rivlerësimit nuk arrijnë të provojnë ekzistencën e këtij kontributi dhe, si pasojë, rezulton që konkluzioni i Komisionit për deklarim të rremë nga subjekti i rivlerësimit është i bazuar.

24.2.3. Më tej, burimi tjetër i krijimit të pasurisë – shuma 1.000.000 (një milion) lekë nga puna e babait në emigracion në Greqi – deklaruar për herë të parë gjatë hetimit administrativ, nuk u provua për nga ekzistenca apo ligjshmëria. Ky konkluzion bazohet së pari në faktin që subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion provues nga punëdhënësi/t e të atit në Greqi për punësimin apo vlerën e pagesës së përfituar dhe periudhën kohore. E vetmja provë e kohës që ka sjellë subjekti është një kontratë huaje e datës 03.06.1996, me nr. {***}, si dhe një kopje të pasaportës së babait që provon qëndrimin, për periudhën 30.05.1993-15.04.1996, në Greqi. Kontrata e huas provon vetëm se babai i subjektit ka dhënë hua 1.000.000 (një milion lekë) në vitin 1996, të cilat i janë kthyer në vitin 1997¹⁹, ndërsa nuk ka detaje për origjinën dhe fatin e të ardhurave nga viti 1997 deri në vitin 2001, kur është blerë apartamenti nga subjekti i rivlerësimit apo gjurmë të ekzistencës së kësaj shume. Kopja e pasaportës provon ligjshmërinë e hyrjes dhe qëndrimit në Greqi të babait të subjektit të rivlerësimit, por jo punësimin, kohëzgjatjen e tij apo dhe ligjshmërinë e të ardhurave nga punësimi në këtë shtet.

24.2.4. Në përgjigje të barrës së provës, subjekti ka pretenduar se të ardhurat e babait nga emigracioni, për periudhën 1993-1996, kanë qenë në vlerën prej 16.000.000 lekësh, nga të cilat 1.000.000 lekë janë dhuratë e dhënë atij, ndërsa një shumë tjetër nga të njëjtat të ardhura [4.300.000 lekë], ka shërbyer për të blerë pasurinë në posedim të subjektit [shtjelluar në vijim]. Vlera që mbetet ka shërbyer për të krijuar dy depozita bankare. Në aktet e fashikullit gjendet, gjithashtu, i administruar dokumentacioni bankar për fonde të depozituara nga babai i subjektit të rivlerësimit në banka të nivelit të dytë, në vitet 2004-2011. Përpos faktit që harku kohor nuk përkon me atë të blerjes së apartamentit, nuk ka gjurmë dokumentare të këtyre fondeve që do të lejonin identifikimin e origjinës së tyre.

¹⁹ Në kontratë vlera është e shënuar me shkrim dore “100.000 lekë + 150.000 lekë + 700.000 lekë + 50.000 lekë”; në krye të kontratës është shënuar po me shkrim dore “mbyllur më 20.02.1997”.

24.2.5. Në përmbledhje të sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar pretendimet e tij për të ardhurat e babait nga punësimi, qoftë për nga ekzistenca, vlera apo ligjshmëria e tyre, nën dritën e kriterit të përcaktuar nga kërkesat e nenit D, pika 3 të Aneksit të Kushtetutës, nenit 30 të ligjit nr. 84/2016 dhe Udhëzimit të Inspektorit të Përgjithshëm të IKDKPKI nr. 4095/2016²⁰, si dhe jurisprudencës së konsoliduar të Kolegjit në çështje të trajtuara, ndër vite, për të ardhurat e pretenduara me prejardhje nga emigracioni²¹. Nga ana tjetër, nga analiza financiare e kryer në Kolegj, rezultoi që të ardhurat e prindërve të subjektit të rivlerësimit deri në vitin 2001 janë më të ulëta se vlera e dhuruar prej 1 milion lekësh. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë ekzistencën dhe ligjshmërinë e burimeve financiare të personit tjetër të lidhur [babait] për të dhuruar shumën 1 milion lekë të deklaruar si kontribut për krijimin e pasurisë apartament.

24.2.6. Mbi bazën e pretendimit të subjektit të rivlerësimit në ankim, në analizën financiare të kryer në Kolegj, në funksion të verifikimit të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë objekt analize, u përfshinë të ardhurat e personit të lidhur [bashkëshortes] për vitet 1994-1999 dhe 2001 – përkundër analizës së kryer në Komision²², ku janë përllogaritur të ardhurat e bashkëshortes vetëm për vitet 1999-2000. Nga ana tjetër, përfshirja në analizë e të ardhurave të përfituara për një periudhë më të gjerë, shoqërohet me përfshirjen në analizë të shpenzimeve përkatëse të periudhës, konkretisht shpenzimet e jetesës për bashkëshorten e subjektit për këto vite, si dhe shpenzimet për blerjen e një automjeti prej saj në shtator 1999 [me vlerë 1 milion lekë]. Këto korrigjime u morën në konsideratë në Kolegj në funksion të analizës së kërkuar nga subjekti.

24.2.7. Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit, për kursin e këmbimit Lekë-USD të përdorur për periudhën 1991-2001, rezultoi se në mungesë të akteve që provojnë se konvertimi ka ndodhur në vitet e mëparshme, Komisioni ka përdorur kursin e vitit 2001. Në analizën e kryer në Kolegj rezultoi që edhe nëse do të merrej në konsideratë pretendimi se subjekti i konvertonte rregullisht të ardhurat në monedhën USD, për çdo vit nga 1991 deri në 2001 [viti kur bleu pasurinë e paluajtshme shkak ankimi], konvertimi logjikisht do të duhej të kryhej pas zbritjes së shpenzimeve vjetore në monedhën zyrtare të Republikës së Shqipërisë, në kushtet kur subjekti dhe personi i lidhur kanë qenë magjistratë të paguar nga buxheti i shtetit shqiptar, në monedhën zyrtare të vendit. Me fjalë të tjera, vlera e konvertuar mund të përkohet logjikisht me kursimet vjetore dhe jo me totalin e pagave të dy gjyqtarëve të paguar në lekë të konvertuara në USD për gjithë periudhën, sikundër pretendon subjekti në përllogaritjet e tij. Për këto arsye, trupi gjykues i Kolegjit çmon se ky pretendim i subjektit është i pabazuar.

24.2.8. Nga analiza financiare e kryer në Komision, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë rezultuar me mungesë burimesh të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie në vitin 2001 në vlerën 3.140.103 lekë. Në përllogaritjen e kryer në Kolegj mbi bazën e shkaqeve të ankimit të ngritura nga subjekti i rivlerësimit, me gjithë korrigjimet e zbatuara – duke marrë në konsideratë të ardhurat e bashkëshortes, por edhe shpenzimet e kryera prej saj gjatë kësaj periudhe, si dhe duke zbritur shpenzime për djalin për dy muajt e parë të vitit 2000 – balanca negative thellohet²³. Në konsideratë

²⁰ <https://www.ildkpk.al/dokumenta-te-tjera/>

²¹ *Shih, ndër të tjera, vendimet: JR nr. 12/2008, që i përket subjektit të rivlerësimit B. D.; JR nr. 09/2018 që i përket subjektit të rivlerësimit A. Xh.; JR nr. 15/2019 që i përket subjektit të rivlerësimit D. Rr.; JR nr. 06/2019 që i përket subjektit të rivlerësimit A. S.; JR nr. 32/2019 që i përket subjektit të rivlerësimit B. M.; si dhe JR nr. 14/2021, që i përket subjektit të rivlerësimit I. B., në <https://kpa.al/juridiksion-rivleresimi-vendime/>.*

²² *U konstatua se Komisioni, në analizën e kryer për blerjen e pasurisë apartament, në vitin 2001, nuk ka përllogaritur të ardhurat e bashkëshortes së subjektit, për periudhën 1994-1999, por nuk ka përfshirë as shpenzimet e kryera nga kjo e fundit për këto vite.*

²³ *Sipas përllogaritjes së kryer në Kolegj, analiza financiare e kryer deri në datën e blerjes së apartamentit [16 korrik 2011], rezultoi me një bilanc negativ prej (-) 3.189.129 lekësh. Ky rezultat vjen pasi përfshirja e të ardhurave të bashkëshortes për periudhën 1994-1999, në zbatim të korrigjimeve të pretenduara nga subjekti, shoqërohet me përfshirjen e shpenzimeve të kryera nga bashkëshortja për këtë periudhë, përfshi blerjen e një automjeti në vitin 1999 në vlerën 1 milion lekë, vlera e të cilit mungon në përllogaritjen e kryer nga Komisioni për verifikimin e mundësisë së krijimit të pasurisë apartament në vitin 2001.*

të garancive procedurale të procesit, trupi gjykues i Kolegjit thekson që nga analiza e kryer në Kolegjin konfirmohet minimalisht vlera e mësipërme e mungesës së burimeve për blerjen e kësaj pasurie në vitin 2001.

I/B. Shitja e apartamentit

24.3.1. Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar apartamentin në fjalë në rubrikën “Deklarimi i pasurive”, me pjesë takuese 100%. Nga ana tjetër, subjekti, po aty, ka deklaruar të ardhurat nga shitja e këtij apartamenti në vitin 2012, në vlerën 8.8 milionë lekë. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012, subjekti ka deklaruar shitjen e apartamentit vjehrrës²⁴. Të ardhurat e përfituara, sipas deklaratës, kanë qenë burim për blerjen e një automjeti [Audi A3], në vlerën 25 mijë euro në të njëjtin vit, si dhe për krijimin e gjendjes *cash* në vlerën 1 milion lekë.

24.3.2. Në ankim, ashtu si edhe në shpjegimet gjatë barrës së provës në Komision, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar përmbushjen e dispozitave ligjore në procesin e shitjes, forcën provuese të kontratës, faktin që janë shlyer dhe detyrimet financiare ndaj shtetit. Përgjigjet e shlyer jashtë zyrës noteriale, pasi në vitin 2012, argumenton subjekti, nuk ka qenë detyrim ligjor që transaksionet financiare të shitjes të dokumentoheshin me akt shkresor apo që vlerat monetare të kalonin në rrugë bankare. Po ashtu, subjekti pretendon se detyrimi për deklarimin *cash*, sipas ligjit nr. 9040/2003 – për diferencën e shumës në gjendjen *cash* që nuk është pasqyruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012 – është vendosur me ndryshimet e miratuara me ligjin nr. 45/2014 dhe, për pasojë, nuk e ka deklaruar.

24.3.3. Nga përmbajtja e vendimit të Komisionit rezulton se konkluzioni për fiktivitet të kontratës ka ardhur për shkak se subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar kalimin në favor të tij të vlerës pas shitjes, si rrjedhojë e mungesës së burimeve financiare të vjehrrës për blerjen e apartamentit. Komisioni ka potencuar fiktivitetin e kontratës në raport me analizën e të ardhurave të vjehrrës së subjektit të rivlerësimit. Znj. L. V. ka rezultuar në mungesë të burimeve të ligjshme financiare për blerjen e apartamentit. Trupi gjykues i Kolegjit kreu një analizë më të thelluar e gjithëpërfshirëse për kontratën, duke përfshirë edhe aspektet e analizuara nga Komisioni. Në përmbledhje të kësaj analize, rezulton që konkluzioni i Komisionit është i drejtë. Kontrata e shitjes së apartamentit është fiktive, dhe ka përbërë një përpjekje për të justifikuar blerjen e automjetit në vlerën 25 mijë euro nga subjekti i rivlerësimit. Arsyeja ku mbështetet ky konkluzion përfshin disa aspekte dhe shtjellohet në vijim.

24.3.4. Së pari, nga analiza e akteve në fashikull, përfshirë deklaratën e pasurisë dhe ato periodike, rezulton se kontrata e shitjes është e vetmja gjurmë që ka lënë ky veprim juridik. Në deklaratat periodike vjetore të plotësuar, ndër vite, nga subjekti dhe personi i lidhur ky veprim dhe pasojat financiare që ai ka sjellë për subjektin e rivlerësimit – në formën e të ardhurave të gjeneruara – ka gjetur pasqyrim vetëm në vitin 2012, në funksion të deklarimit të automjetit të blerë. Edhe në deklaratën e pasurisë [*vetting*] subjekti, jo vetëm që nuk ka specifikuar vlerën monetare të pretenduar se ka mbetur *cash* në shtëpi, ndër vite, por e ka deklaruar apartamentin në pronësi 100%, ndonëse në të njëjtin rubrikë pretendon të ardhura nga shitja.

24.3.5. Së dyti, fiktiviteti i kontratës rezulton qartë, nëse analizohen objektivisht dhe me një logjikë të thjeshtë faktet nga ana financiare. Konkretisht, pretendohet të pranohet një kontratë, sipas së cilës vjehri dhe vjehra e subjektit të rivlerësimit kanë paguar vlerën e plotë prej 8.8 milionë lekësh në vitin 2012, sipas rivlerësimit, për një apartament për të cilin kishin kontribuar në vitin 2001, nëpërmjet dhurimit ekuivalentin në USD të shumës 2.226.450 lekë [53% të vlerës së apartamentit] – në variantin e prezantuar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003, duke shkuar kështu kontributi i tyre për të njëjtin apartament në vlerën mbi 11 milionë lekë [afërsisht]. Nga ana tjetër,

²⁴ Sipas kontratës noteriale nr. {***}, datë 07.04.2012, apartamenti i është shitur nënës së bashkëshortes, znj. L. V., në vlerën 8.800.000 lekë.

sipas këtij pretendimi, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë investuar 1.9 milionë lekë – ekuivalentin e 13 mijë USD ose 46% të vlerës fillestare – dhe kanë përfituar 6.9 milionë lekë nga diferenca mes kontributit të tyre në vitin 2001 dhe çmimit të tregut të aplikuar për prindërit e bashkëshortes. Pagesa e vlerës së tregut në blerjen e kësaj prone nga prindërit e bashkëshortes duket jo bindëse, sidomos në kushtet kur ata ishin dhurues të 53% të vlerës së blerjes së apartamenti, ndërsa subjekti dhe vajza e tyre përfitonte 6.9 milionë lekë edhe për shkak të dhurimit të bërë prej tyre.

24.3.6. Fiktiviteti i kontratës mbetet i vetmi shpjegim logjik, edhe nëse pranohet pretendimi i subjektit të rivlerësimit mbi bazën e deklaratës noteriale të vitit 2015, lëshuar nga znj. L. V. – e konkretisht që vlera 15 mijë USD nuk shërbeu për apartamentin në vitin 2001. Ky konkluzion merr në konsideratë një analizë gjithëpërfshirëse të situatës faktike të parashtruar. Konkretisht, në thelb, fakti që prindërit e personit të lidhur pretendohet të kenë kontribuar vazhdimisht dhe rregullisht në dobi të mirëqenies financiare të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes e bën të pakuptimtë faturimin ndaj tyre të vlerës së apartamentit, sipas kontratës së shitjes, ndërkohë që prindërit kishin kontribuar një herë për më shumë se gjysmën e vlerës së blerjes. Ky konkluzion është pasojë e konstatimit që mënyra sesi e prezanton raportin familjar subjekti i rivlerësimit dëshmon një balancë disproporcionale dhe alogjike, në kushtet kur parashtrohen rrethana fakti, sipas të cilave prindërit e bashkëshortes kontribuonin me dhurime përfshirë edhe duke blerë pasurinë për të cilën kanë dhuruar 53% të vlerës në dyfishin e kostos fillestare apo kalojnë pronësi e përfitime në favor të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit [siç shtjellohet për pasuritë e tjera të analizuara në vijim], ndërsa subjekti dhe bashkëshortja mbeten ndër vite në rolin e përfituesit të përhershëm dhe jo rrallë të vetëm. Kjo situatë e pretenduar, ku bamirësia, mirëkuptimi dhe favorët për shkak të marrëdhënies së afërt prind-fëmijë shkon vetëm në një kah – në favor të subjektit dhe bashkëshortes – sfidon logjikën dhe, për pasojë, është jo bindëse. Përpos sa më sipër, ky raport i pretenduar marrëdhëniesh me përfitim vetëm njëkahësh është jo bindës edhe nën dritën e faktit që prindërit e bashkëshortes kanë kryer investime në blerje pronash, ndërsa nuk rezultojnë me tepri burimesh financiare²⁵, përkundrazi.

24.3.7. Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se është i pabazuar edhe pretendimi i subjektit të rivlerësimit se nuk ka pasur detyrimin për të deklaruar gjendjen *cash* para hyrjes në fuqi të ligjit 45/2014. Ligji nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, sipas përcaktimeve në vitin 2012, në kohën kur subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shitjen e apartamentit, në nenin 4, germa “d”, parashikonte detyrimin për të deklaruar “[...] (d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në *cash*, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj [...]”. Në këtë linjë ka qenë edhe formulari i deklarimit të pasurisë për vitin 2012, i plotësuar nga subjekti i rivlerësimit, në faqen 3 të të cilit specifikohet mënyra se si duhen deklaruar interesat, duke specifikuar në rubrikën e objektit të deklarimit edhe “[...] (d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në *cash*, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj [...]”.

24.3.8. Nën dritën e sa më sipër, në rastin konkret rezulton që subjekti, ndonëse ka pasur detyrimin ligjor, nuk rezulton të ketë deklaruar gjendjen *cash* në fund të vitit 2012, sikurse në asnjë nga vitet pasardhëse shumë që do t’i korrespondonte vlerës së mbetur pas blerjes së automjetit në vitin 2012. Për herë të parë, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjendje *cash*, duke iu referuar të ardhurave nga shitja e apartamentit, në deklaratën periodike të vitit 2016, plotësuar pas deklaratës së pasurisë *vetting*, në mars 2017, kohë që përkon me nisjen e procesit të rivlerësimit.

²⁵ Nga analiza e kryer në Komision, pasuritë dhe likuiditetet e prindërve të personit të lidhur me subjektin arrijnë vlerën prej rreth 40.792.471 lekësh deri në vitin 2014, [nga të cilat rreth 24 892 471 lekë deri në vitin 2010 para blerjes së apartamentit me vlerë 8 800 000 lekë nga subjekti], ndërkohë që të dy rezultojnë të kenë të ardhura nga pensionet e pleqërisë e invaliditetit që para viteve 1990.

24.3.9. Në përmbledhje të sa është analizuar më sipër, trupi gjykues i Kolegjit çmon se subjekti i rivlerësimit ka dështuar të provojë të kundërtën e konkluzioneve të Komisionit, pasi ka lidhur një kontratë fiktive për shitjen e apartamentit objekt analize, me qëllim justifikimin e krijimit të fondeve të referuara si burim për krijim pasurish në vijim. Në përfundim, për këtë pasuri, trupi gjykues i Kolegjit arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të rremë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, për sa i përket burimit të krijimit të saj, si dhe ka mungesë burimesh të ligjshme për krijimin e pasurisë, minimalisht në vlerën e konstatuar gjatë hetimit administrativ në Komision, referuar në paragrafin 24.2.8. Për rrjedhojë, subjekti gjendet në kushtet e parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronjat “b” dhe “ç” e ligjit nr. 84/2016.

*II. Pasuria në përdorim – ndodhur në të njëjtën adresë, rruga “{***}”, me numër apartamenti {***}*

25. Komisioni ka konstatuar se subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën e pasurisë [vetting] pasurinë në posedim dhe në përdorim që nga viti 2012, sikurse as burimin e ligjshëm të krijimit të saj. Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti nuk provoi burimin e ligjshëm të përfitimit të të ardhurave nga babai si person tjetër i lidhur, sipas ligjit nr. 84/2016, për blerjen e këtij apartamenti (në vlerën 4.300.000 lekë), pasi nuk janë dokumentuar dhe provuar të ardhurat nga emigracioni, si dhe mundësitë financiare, në raport me burimet e ligjshme, të babait për blerjen e apartamentit. Në përfundim, Komisioni konkludoi që subjekti ka kryer fshehje të kësaj pasurie dhe nuk arriti të provojë bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të saj.

25.1. Subjekti parashtron në ankim se e ka ezauruar përgjegjësinë për deklarimin e përdorimit të këtij apartamenti, duke e deklaruar si vendbanim në rubrikën “*Të dhëna personale të subjektit dhe personave të lidhur*”, në deklaratën e pasurisë. Kjo pasuri në pronësi të babait, në kuptim të nenit 13, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, nuk e cilëson atë [babanë] në rrethin e personave të lidhur. Prindërit e tij nuk figurojnë në certifikatën familjare, gjithashtu, babai ka pasur të ardhura të konsiderueshme nga emigracioni, për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie.

25.2. Në konsideratë të konkluzioneve të Komisionit, akteve në fashikull dhe pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson që deklarimi i kryer për këtë pasuri në deklaratën vetting – që kufizohet në cilësimin si vendbanim – pa qartësuar marrëdhënien e përdorimit në rubrikën që i dedikohet deklarimit të pasurive në deklaratën e pasurisë, nuk përmbush detyrimet që përcakton Neni D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, pretendimet e subjektit të rivlerësimit janë të pabazuara. Ky konkluzion i trupit gjykues është pasojë e analizës së shtjelluar në vijim, të dispozitave kushtetuese dhe ligjore që normojnë detyrimet e subjekteve të rivlerësimit në proces dhe rrethanave faktike të konstatuara nga aktet në fashikull.

25.3. Trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje që kjo pasuri (në vijim apartamenti nr. {***}), e cila figuron në emër të babait të subjektit të rivlerësimit, deklarohet në përdorim të subjektit të rivlerësimit *minimalisht* prej vitit 2012. Apartamenti ndodhet në të njëjtën ndërtesë me pasurinë e sipëranalizuar në pjesën e numërtuar I (në vijim, apartamenti nr. {***}). Nga përmbajtja e akteve në fashikull paraqitet një situatë në të cilën subjekti, bashkëshortja dhe nëna e bashkëshortes deklarojnë si adresa këto dy apartamente në mënyrë të ndërsjellë dhe jokonseguente, në veprime të ndryshme të paktën duket filluar nga viti 2007, pesë (5) vjet përpara momentit, kur pretendohet të ketë nisur përdorimi i apartamentit nr. {***} dhe shitja e apartamentit nr. {***}, znj. L. V.. Konkretisht, përpos deklarimit “*në pronësi*” në janar 2017, në deklaratën e pasurisë, të apartamentit nr. {***} të shitur në vitin 2012, subjekti i rivlerësimit e referon si adresën në të cilën është regjistruar në gjendjen civile apartamenti nr. {***}. Më tej, nga deklaratat periodike vjetore të plotësuar nga subjekti dhe bashkëshortja, rezulton që vetë subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar apartamentin në pronësi të të atit [nr. {***}] si adresën e regjistrimit në gjendjen civile duke filluar nga viti 2009. Bashkëshortja ka deklaruar si adresë regjistrimi në gjendjen civile apartamentin në pronësi deri në vitin 2012 [apartamenti nr. {***}]. Në vitin 2012, bashkëshortët Balliu kanë

deklaruar si adresa regjistrimi në gjendjen civile dy apartamente të ndryshme, nr. {***} dhe nr. {***} [në të njëjtën ndërtesë]. Nga ana tjetër, nga aktet në fashikull rezultojnë që bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka deklaruar si adresë apartamentin në emër të vjehrrit [nr. {***}] në kontrata noteriale shitjeje që në vitin 2007²⁶, në mospërputhje me adresën e deklaruar në deklaratat periodike – në të cilat ka deklaruar apartamentin nr. {***}, atë në pronësi të saj dhe bashkëshortit formalisht deri në vitin 2012. Po ashtu, edhe vjehrra e subjektit të rivlerësimit, znj. L. V., duket se ka deklaruar si adresë banimi që në vitin 2007, apartamentin nr. {***}, për të cilin ka nënshkruar kontratë blerjeje në vitin 2012²⁷. Më fjalë të tjera, në dy akte noteriale, kontrata shitjeje pasurish, që mbajnë të njëjtën datë, 26.11.2007, përpara së njëjtës notere, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit dhe nëna e saj kanë deklaruar adresa banimi respektivisht: znj. R.B. apartamentin në pronësi të vjehrrit, ndërsa znj. L.V., apartamentin në pronësi të së bijës dhe bashkëshortit të kësaj të fundit. Znj. L. V. ka deklaruar apartamentin në pronësi të së bijës dhe subjektit të rivlerësimit edhe në kontrata noteriale – heqje dorë nga pronësia dhe shitjeje të vitit 2009²⁸. Ndërkohë, nga aktet në fashikull rezultojnë se babai i subjektit të rivlerësimit ka në pronësi edhe një apartament tjetër²⁹ në Tiranë. Këto akte, ndër të tjera, dëshmojnë minimalisht për ekzistencën e një të drejtë reale mbi apartamentin në përdorim për një periudhë të gjatë kohore, marrëdhënie e cila përkon me detyrimin e subjektit të rivlerësimit për deklarim ndër vite dhe në deklaratën e pasurisë *vetting*.

25.4. Nga leximi i kombinuar i dispozitave që rregullojnë deklarimin e pasurive në funksion të procesit të rivlerësimit nga subjektet – konkretisht pika 1 e nenit D³⁰ të Aneksit të Kushtetutës, nenit 30 të ligjit nr. 84/2016 dhe përkufizimit të pasurive që i nënshtrohen deklarimit për efekt të procesit të rivlerësimit, sipas pikës 11, të nenit 3³¹ të ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003, si dhe Udhëzimit nr. 4095/2016, të Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, rezultojnë qartë detyrimi i subjektit të rivlerësimit, z. Arian Balliu, për të deklaruar këtë pasuri të cilën e kishte në përdorim prej vitesh në momentin e depozitimit të deklaratës së pasurisë. Po ashtu, pika 5, e nenit D të Aneksit të Kushtetutës parashikon edhe sanksionin disiplinor, në kushtet kur një subjekt rivlerësimi fsheh apo paraqet në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi apo posedim e përdorim³². Në këto kushte, rezultojnë qartazi i pabazuar pretendimi i subjektit të rivlerësimit se ka ezauruar këtë detyrim kushtetues, duke shkruar në deklaratë adresën e vendbanimit, pa asnjë të dhënë për marrëdhënien e tij afatgjatë me këtë pasuri. Nga ana tjetër, nëse do të pranohej ky interpretim i subjektit të rivlerësimit, kontrollit do t'i nënshtroheshin pasuritë sipas adresave të vendbanimeve të subjekteve të rivlerësimit dhe jo pasuritë në përdorim e posedim. Po ashtu, ky kuadër normativ, i cili kërkon detyrimin për burimet e krijimit të pasurive, do të përfshinte në këtë detyrim edhe pasuritë për të cilat subjektet kanë lidhur

²⁶ Në kontratën e shitjes së apartamentit në Kavajë, më datë 26.11.2007, me nr. {***} Rep., nr. {***} Kol., përpara noteres F. Sh..

²⁷ Kontratë shitjeje e një apartamenti në Kavajë, datë 26.11.2007, me nr. {***} Rep., nr. {***} Kol., përpara noteres F. Sh..

²⁸ Respektivisht, në 30 janar dhe 2 shkurt 2009, përpara noteres V. S. me nr. {***} Rep., nr. {***} Kol. dhe kontrata me nr. {***} Rep., nr. {***} Kol.

²⁹ Apartament i përfutur nga privatizimi i banesave, në bashkëpronësi, tek i cili subjekti i rivlerësimit është bashkëpronar në pjesë të barabarta me prindërit.

³⁰ Pika 1 e nenit D të Aneksit të Kushtetutës përcakton: “1. Subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklarimit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur [...]”.

³¹ Sipas kësaj dispozite: “[11.] “Pasuri” janë të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, sipas parashikimit të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2013, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar që janë në pronësi, posedim ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit [...]”.

³² Pika 5 e Nenit D të Aneksit të Kushtetutës përcakton, ndër të tjera, që: “[...] Nëse subjekti i rivlerësimit përpigjet të fshehtë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën”.

veprime juridike të tjera, si qiratë. Qartazi, nga mënyra si janë formuluar dispozitat, rezulton se pretendimi i subjektit përbën alogjizëm që ka për qëllim të evitojë mungesën e deklaramit prej tij.

25.5. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit që përdorimi i pasurisë nuk është një ndër marrëdhëniet juridike të parashikuara nga neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, që krijojnë cilësinë prej personit tjetër të lidhur, është i bazuar. Pavarësisht nga ky fakt, nën dritën e detyrimeve që rrjedhin për institucionet e rivlerësimit për të hetuar për pasuritë në përdorim, sipas pikave 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, në drejtim të verifikimit të rrethanave që mund të ngrenë dyshime për fshehjen apo paraqitjen në mënyrë të pasaktë të pasurive në përdorim të subjekteve të rivlerësimit³³, trupi gjykues i Kolegjit vëren se hetimi i kryer nga Komisioni, për mundësitë financiare të babait të subjektit të rivlerësimit për krijimin e kësaj pasurie, është i bazuar. Nga aktet në fashikull rezulton se Komisioni ka hetuar në drejtim të verifikimit të burimeve të ligjshme të babait të subjektit për të blerë apartamentin, bazuar në deklaramet e subjektit se babai ka pasur të ardhura të konsiderueshme nga emigracioni.

25.6. Nga depozitimet bankare ndër vite, paraqitur si prova në Komision nga subjekti i rivlerësimit, vlera e tyre rezulton afërsisht 3.700.000 lekë³⁴. Po ashtu, nga dokumentacioni bankar rezulton se derdhjet në llogaritë bankare janë kryer në vitet 2003-2004, ndërkohë që apartamenti është blerë nga babai i subjektit të rivlerësimit në vitin 1999. Në kushtet e këtij hendeku kohor mes depozitave dhe datës së blerjes së apartamentit, trupi gjykues vëren që subjekti i rivlerësimit nuk arrin të provojë përdorimin e këtyre të ardhurave për blerjen e apartamentit.

25.7. Pa përsëritur arsyetimin e shtjelluar në paragrafët e sipërcituar të këtij vendimi, në funksion të analizës së burimit të ligjshëm të dhurimit prej 1.000.000 lekësh nga babai i subjektit të rivlerësimit, deklaruar si burim për blerjen e apartamentit, trupi gjykues i Kolegjit çmon të risjellë në vëmendje se të ardhurat nga emigracioni, mbeten në nivel deklarativ, si përsa i përket vlerës, ashtu edhe ekzistencës së tyre e ligjshmërisë. Subjekti i rivlerësimit nuk e mbështeti këtë pretendim në dokumentacion ligjor. Për pasojë, të ardhurat e pretenduara nga emigracioni, nuk mund të konsiderohen të ardhura të ligjshme në kuptimin e ligjit nr. 84/2016.

25.8. Për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit çmon se rezulton i bazuar vlerësimi i Komisionit se subjekti nuk ka arritur të provojë bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë në përdorim, pasi babai nuk justifikon me të ardhura të ligjshme blerjen e apartamentit në vlerën 4.300.000 lekë në datën 21.05.1999.

25.9. Bazuar në rrethanat faktike dhe nën dritën e përcaktimeve kushtetuese e ligjore të cilat normojnë deklaramin e pasurive në përdorim, trupi gjykues i Kolegjit konkludon se subjekti i rivlerësimit nuk ka përmbushur detyrimet e tij, sipas nenit D, pikat 1 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe ka fshehur përdorimin e kësaj pasurie, prej vitit 2012. Për këtë arsye, konkluzioni i Komisionit është i bazuar.

*III. Apartamenti 1+1, me sipërfaqe 70 m², me adresë rruga “{***}”, Tiranë³⁵*

- 26.** Në vendimin objekt shqyrtimi, lidhur me këtë pasuri, Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit: (i) ka kryer deklaram të pasaktë lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie; (ii) e ka blerë nën çmimet e tregut; (iii) nuk arriti të provonte shërbimet që ka kryer si avokat ndaj shoqërisë

³³ Shtjelluar në detaj në vendimet e Kolegjit në çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit Sh. K. [JR nr.7/2020] dhe në çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit F. I. [JR 10/2022].

³⁴ Sipas pretendimeve të subjektit në hetim, kjo vlerë ishte rreth 5.000.000 lekë te “ProCredit Bank” dhe rreth 5.000.000 lekë te “Raiffeisen Bank”, vlerë shumë më e lartë sesa ajo që dëshmojnë aktet.

³⁵ Blerë më datë 17.12.2015, në bazë të kontratës noteriale të sipërmarrjes, datë 22.10.2007, në vlerën 2.000.000 lekë.

shitëse, të ardhurat përkatëse të përfituara, si dhe as pagimin e detyrimeve tatimore lidhur me këto të ardhura të pretenduara; si dhe (iv) ka qenë në konflikt interesi me z. A. Gj., me të cilin ka lidhur kontratën e sipërmarrjes dhe, më pas, të shitjes së kësaj pasurie në vitin 2015.

26.1. Subjekti i rivlerësimit argumenton në ankim që deklarimi në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës në vitin 2009 nuk është i pasaktë. Në këtë dokument [subjekti] ka deklaruar vlerën e blerjes prej 2 milionë lekësh dhe atë të shpenzimeve prej 900.000 lekë. Mosdetajimi i këtyre vlerave nuk mund të konsiderohet si deklarim i rremë ose i pasaktë. Mospërputhja është pasojë e kërkesës në deklaratën periodike që të deklarohet edhe shuma e shpenzimeve të kryera. Pasuria ka si burim të ardhurat e krijuara gjatë ushtrimit të profesionit të avokatit, për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Si shpërblim për punën e kryer pa pagesë, si avokat i shoqërisë “{***}” në disa procese gjyqësore, subjektit i është dhënë mundësia të blejë apartamentin. Ky aspekt është formalizuar më datë 22.10.2007, me kontratën noteriale të sipërmarrjes dhe vlerën 2 milionë lekë. Sa i përket mungesës së dokumenteve, nuk ka asnjë detyrim ligjor për ruajtjen e dokumenteve tatimore në lidhje me pagesat e përfituara si avokat për më tepër se 5 vjet. Nuk ka konflikt interesi të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në procesin gjyqësor me palë z. A. Gj., pasi ky individ ka qenë përfaqësues me prokurë i shoqërisë “{***}” vetëm për nënshkrimin e kontratës së shitblerjes së pasurisë. Detyrimet ndaj shoqërisë për këtë pasuri janë shlyer që në vitin 2007. Gjykimi i z. A. Gj. në Gjykatën e Apelit Durrës, nga trupi gjykues i kryesuar nga subjekti i rivlerësimit, është zhvilluar në bazë të shortit të hedhur në gjykatë. Pasuria nuk është blerë nën çmimet e tregut. Referimi në Udhëzimin Nr. 2, datë 04.04.2007, për koston e ndërtimit nga Komisioni është i gabuar. Objekti ku ndodhet apartamenti është ndërtuar në vitet 2001-2003 dhe llogaritja e koston së ndërtimit duhet të bëhet, sipas akteve nënligjore në fuqi në këto vite, me një vlerë mesatare 28.749 lekë/m².

26.2. Pasi shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit, konkluzionet e Komisionit në vendim dhe aktet në fashikull, nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim në rrethanat konkrete faktike, trupi gjykues i Kolegjit gjen që edhe ky shkak ankimi është i pabazuar. Me shpjegimet dhe argumentet e parashtruara në ankim, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të zhbënte sa ka konkluduar Komisioni. Ky përfundim bazohet në analizën e shtjelluar në detaj në vijim.

III/A Për vlerën dhe burimin e krijimit të pasurisë

26.2.1. Së pari, nga aktet në fashikull rezulton që në deklaratën e pasurisë [vetting] subjekti ka deklaruar apartamentin me të dhënat përkatëse [1+1 dhe sipërfaqe 70 m²] dhe specifikuar vlerën 2.000.000 lekë; burimi i krijimit janë deklaruar të ardhurat e përfituara nga ushtrimi i profesionit të avokatit. Në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2009, subjekti ka deklaruar apartamentin me të dhëna të ndryshme për nga specifikimet [2+1, me sip.78 m²], si dhe për nga vlera, e cila është deklaruar 2.900.000 lekë. Burimi i krijimit mungon.

26.2.2. Nga aktet rezulton se në mbështetje të pretendimit për investime në vlerën prej 900 mijë lekësh për këtë pronë, subjekti ka paraqitur në Komision një aktmarrëveshje me shoqërinë ndërtuese, që mban datën 16.11.2007, lidhur jashtë zyrës noteriale, për kryerjen dhe pagesën e punimeve shtesë, disa mandatpagesa në vlerën 700 mijë lekë, në emër të shoqërisë ndërtuese [për pagesë punimesh dhe materiale], si dhe një deklaratë të datës 28.01.2019 të përfaqësuesit të një shoqërie për blerje mobiljesh “rreth muajit shkurt të vitit 2008”, në vlerën 200 mijë lekë. Gjithashtu, subjekti ka paraqitur si provë edhe një deklaratë noteriale të lëshuar në datën 26.09.2019, nga ortakja e vetme dhe administratorja e shoqërisë “{***}” ShPK, znj. E. D., në të cilën ajo deklaron se kishte qenë në vështirësi financiare dhe shleu detyrimet për përfaqësime dhe konsulta ligjore ndaj z. Arjan Balliu, duke i ofruar këtij të fundit një apartament kundrejt pagesës prej 2 milionë lekësh cash.

26.2.3. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se të dhënat që kërkohen për pasuritë janë të njëjta, qoftë në deklaratat vjetore periodike, ashtu edhe në deklaratën e pasurisë [vetting]. Konkretisht, në rubrikat e dedikuara përshkrimin të pasurive, kërkohet: *vlera e blerjes së pasurisë, sipas kontratës së shitjes dhe*

në mungesë të dokumentacionit për shpenzimet e kryera, vlera e tyre³⁶. Për rrjedhojë, mospërputhja e vlerës së deklaruar të apartamentit në dy deklaratat në fjalë, nuk mund t'i atribuohet mënyrës së formulimit të kërkesave në formularin e deklarimit të pasurisë. Për këtë arsye, ky pretendim i subjektit është i pabazuar. Subjekti ka kryer deklarim të pasaktë për vlerën e kësaj pasurie.

26.2.4. Nga analiza e akteve dhe rrethanave faktike konkrete, nën dritën e legjislacionit që rregullon ushtrimin e avokatisë, rezulton se pretendimi i subjektit, se burim krijimi i kësaj pasurie janë të ardhurat nga avokatia dhe shpërblimi për punën e kryer për shoqërinë “{***}”, është i pambështetur në prova dhe jo bindës. Detyrimet e pretenduara nga shoqëria kundrejt subjektit të rivlerësimit nuk u provuan me asnjë dokumentacion dhe, për pasojë, nuk mund të argumentohen si burim krijimi në nivel parimor. Në zbatim të legjislacionit në fuqi³⁷ në kohën në fjalë – tetor 2007 – subjekti i rivlerësimit ushtronte profesionin e avokatit mbi bazën e lejes për ushtrimin e profesionit dhe të regjistrimit në organet tatimore. Subjekti rezulton të jetë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit si person fizik (avokat) në datën 10.10.2007 dhe është pajisur me NIPT. Për rrjedhojë, duke filluar nga data e regjistrimit, çdo shërbim i subjektit të rivlerësimit për klientët, përfshirë shërbimet e kryera shoqërisë “{***}”, do të duhej të shoqërohej me faturë tatimore. Në kushtet kur nuk provohet gjenerimi i kësaj shume dhe as pagimi i detyrimeve tatimore që kishin lindur për shkak të përfitimit të saj, nuk përmbushet as kriteri i ligjshmërisë së këtyre të ardhurave – në zbatim të përcaktimit të shprehur të pikës 3, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës³⁸.

26.2.5. Së dyti, edhe nëse abstragohet nga sa më sipër, pretendimi i subjektit, për shpërblime të shlyera nëpërmjet ofrimit të apartamentit, nuk gjen pasqyrim as në përmbajtjen e kontratës së lidhur për shitjen e apartamentit. Deklarata e ortakes dhe administratores së shoqërisë “{***}” ShPK, hartuar gjatë procesit të rivlerësimit [më 26.09.2019], e cila synon të zhbëjë sa palët kanë përcaktuar me kontratën e vitit 2007, konsiderohet pa vlerë provuese në nivel parimor në konsideratë të dispozitave të nenit 690 të Kodit Civil, për peshën që kanë parashikimet e palëve në një kontratë të hartuar në përputhje me ligjin³⁹. Po ashtu, deklarata në fjalë është hartuar gjatë procesit të rivlerësimit dhe paraqet rrethana faktike të cilat përpiqen të kundërshtojnë përmbajtjen e një kontrate të hartuar lirish nga palët në kohën e veprimit juridik. Si e tillë, deklarata e znj. E. D. u pa nga trupi gjykues i Kolegjit, si një përpjekje për të përmirësuar situatën e subjektit të rivlerësimit. Trupi gjykues i Kolegjit çmon të sjellë në vëmendje edhe qëndrime të mëparshme të Kolegjit, në të cilat

³⁶ Në rubrikën që i dedikohet deklarimit të pasurive, formulari [shtojca nr. 4 e ligjit nr. 84/2016] shprehimisht specifikon detyrimin për deklarimin e të dhënave si vijon: “Përshkruani hollësisht [...] çmimin e blerjes, në mungesë të dokumenteve, shumën e shpenzimeve që keni kryer [...]”. E njëjta përmbajtje rezulton edhe në kërkesat e faqes 3 të deklaratës përpara fillimit të detyrës, plotësuar nga subjekti në datën 08.10.2009.

³⁷ Ligji nr. 9109, datë 17.07.2003, “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar nga ligji nr. 9795, datë 23.7.2007 dhe ligji nr. 7758, datë 12.10.1993, “Për dokumentimin dhe mbajtjen e llogarive për tatimet”, i ndryshuar, nenet 2 dhe 4, respektivisht – Neni 2: “Ky ligj vepron mbi çdo subjekt, person fizik, i cili ushtron veprimtari profesionale [...] Për zbatimin e këtij ligji, me “veprimtari profesionale” kuptohet çdo veprimtari [...] shërbimi, duke përfshirë edhe profesionet e lira [...]”. Neni 4: “Fatura. Çdo [...] kryerje punimi e shërbimi që destinohen për një veprimtari profesionale, është objekt faturimi. Çdo faturë duhet të përmbajë numrin, datën dhe vendin e lëshimit, emrin dhe adresën e palëve, datën e realizimit të shitjes ose të punimit a shërbimit, emërtimin e saktë të tyre, çmimin e plotë të shitjes dhe, nëse është rasti, rabatet e zbritjet e tjera të zbatuara, si dhe shumat e shifruara, cilado qoftë mënyra e likuidimit të faturës. Faturat për shitjen e sendeve a kryerjen e punimeve e të shërbimeve, të cilat janë objekt i kërimit të një tatimi, janë fatura tatimore [...]”.

³⁸ Shih edhe vendimin e Kolegjit në çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit E. I. [JR] nr. 11/2022 në <https://kpa.al/wp-content/uploads/2022/06/Vendim-Elizabeta-Imeraj-anonimizuar.pdf>, paragrafët 31.7 dhe 31.11.

³⁹ Sipas nenit 690 të Kodit Civil “Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. Ajo mund të prishet ose të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të palëve ose për shkaqe të parashikuara me ligj”.

është argumentuar efekti provues i kushtëzuar i deklaratave noteriale të hartuara gjatë procesit të rivlerësimit⁴⁰.

26.2.6. Në kushtet kur pagesa e apartamentit është kryer vetëm 12 ditë pasi subjekti i rivlerësimit është regjistruar për të ushtruar profesionin e avokatit, më 22.10.2007, argumenti që shtrohet për analizë është nëse brenda 12 ditëve pas licencimit për të ushtruar avokatinë, subjekti mund të kishte kryer një vlerë shërbimesh juridike për shoqërinë “{***}” ShPK, të cilat janë vlerësuar në vlerën prej mbi 4 milionë lekësh. Po ashtu, shtrohet në analizë nëse ky argument përkon me sa dëshmojnë aktet në fashikull. Së pari, trupi gjykues i Kolegjit vëren se ky version faktesh bie qartazi ndesh me sa rezulton nga aktet në fashikull, e konkretisht: vetë subjekti i rivlerësimit, për efekt të detyrimeve tatimore, ka zgjedhur të regjistrohet në kategorinë e bizneseve me xhiro vjetore nga 2 deri në 3 milionë lekë për vitin 2007. Kjo tregon që shpërblimi, që pretendohet të jetë fituar brenda afro dy javësh, ka tejkaluar edhe pritshmëritë e subjektit për tre muajt e vitit 2007 [tetor-dhjetor]. Nga analiza e kryer në Kolegji për të kuptuar si rezulton ky pretendim, nën dritën e detyrimeve tatimore që shoqërojnë fitimet, rezultoi se nëse të ardhurat *neto* nga avokatia do të ishin në nivelin 2 milionë lekë në 12 ditë [sikurse pretendon subjekti], qarkullimi *bruto* i tremujorit të fundit të vitit 2007 do të duhet të kishte qenë 4.000.000 lekë, kurse në terma vjetore do të ishte 16.000.000 lekë të ardhura *bruto*⁴¹. Ndërkohë, *nuk* rezulton që subjekti të ketë paguar tatim shtesë në funksion të këtij fitimi përtej vlerës së parashikuar. Për këtë arsye, edhe nga ky këndvështrim analitik, pretendimi i subjektit të rivlerësimit për burime të krijimit të apartamentit nga shërbimet juridike të kryera prej tij, pasi është licencuar dhe regjistruar si avokat, bie ndesh me dokumentacionin e përpiluar prej tij dhe me faktet. Së fundmi, pavarësisht nga kjo analizë, edhe nëse pranohet pretendimi për krijimin e vlerës prej 2 milionë lekësh *neto* në harkun kohor të 12 ditëve – duke abstrguar sërish nga sa është analizuar për mungesën e faturimit në paragrafin 26.2.4 – në kushtet kur fundviti 2007 do t’i kishte rezultuar me qarkullim *bruto* minimalisht rreth 4 milionë lekë, subjekti i rivlerësimit do të duhet të kishte parapaguar një tatim më të lartë për vitin në vijim. Edhe ky reflektim mbi bazën e fundvitit 2007 nuk rezulton të ketë ndodhur.

26.2.7. Në përmbledhje të analizës të shtjelluar më sipër, pretendimi i subjektit, për fitimin e apartamentit nëpërmjet shërbimeve ligjore të kryera për shoqërinë ndërtuese, rezultoi jo bindës dhe i pambështetur në fakte e në dokumentacion ligjor me vlerë provuese. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se konkluzioni i Komisionit është i drejtë. Subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi dhe burime të mjaftueshme financiare për blerjen e pasurisë shkak ankimi, *minimalisht* në vlerën e përlllogaritur nga Komisioni prej (-) 1.625.000 lekësh⁴². Pretendimet e subjektit mbeten në nivel deklarativ, të paprovuara me dokumentacion ligjor.

⁴⁰ Ndër të tjerë, vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr. 6/2018(JR) që i përket subjektit të rivlerësimit B. N., paragrafët 35 dhe 36; nr. 11/2019(JR), që i përket subjektit të rivlerësimit E. I., paragrafi 27.12.1; nr. 34/2019(JR), që i përket subjektit të rivlerësimit E. P., paragrafi 85.2.

⁴¹ Përlllogaritje e kryer duke u bazuar në marzhin e fitimit maksimal të dy viteve pasardhëse 50% e vlerës 4 milionë lekë bruto që është e barabartë me 2 milionë lekë fitim neto.

⁴² Komisioni rezulton se ka ndjekur një qasje maksimalisht favorizuese për përlllogaritjen e të ardhurave pasi: (i) ka përfshirë në llogaritje qarkullimin maksimal vjetor prej 3 milionë lekë, megjithëse vetë subjekti e ka parashikuar qarkullimin në vlerën 2.5 milionë lekë, ndërsa në fakt qarkullimi real vjetor i biznesit në dy vitet në vijim ka qenë shumë më i ulët, përkatësisht 1.7 dhe 1.95 milionë lekë; (ii) mbi qarkullimin maksimal ka përlllogaritur fitimin për tre muajt, ndërkohë që periudha nga licencimi deri në blerjen e pasurisë ka qenë vetëm 12 ditë; (iii) ka përdorur marzh fitimi maksimal prej 50%, ndërkohë që marzhi i fitimit neto mbi qarkullimin për dy vitet pasardhëse ka qenë konsiderueshëm më i ulët – përkatësisht 31.7 dhe 43.8%. Nëse përlllogaritja do të kryhej mbi shifrat që rezultojnë nga aktet, pamundësia financiare e subjektit të rivlerësimit do të thellohej konsiderueshëm, duke shkuar në vlerën 1.960.625 lekë.

III/B. Për çmimin e blerjes kundrejt vlerës së tregut

26.3. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit se ky apartament është blerë nën çmimet e tregut, referimi në Udhëzimin Nr. 2/2007, për sa i përket kostos së ndërtimit është i gabuar, pretendon ai. Llogaritja e koston së ndërtimit duhet të bëhet sipas akteve nënligjore në fuqi në vitet 2001-2003, kohë që përkon me ndërtimin e objektit ku ndodhet apartamenti, argumenton subjekti i rivlerësimit. Vlera mesatare për këtë periudhë është 28.749 lekë/m². Së fundmi, subjekti argumenton edhe që asnjë apartament në atë objekt nuk është blerë apo shitur në apo mbi vlerën e tregut⁴³, por kjo nuk do të thotë se të gjithë këta shtetas kanë kryer kontrata fiktive apo fshehje të ardhurash⁴⁴.

26.3.1. Komisioni në vendim ka konstatuar që vlera e aplikuar nga shitësi është 71% më e ulët sesa vlera e tregut për këtë apartament, e cila do të ishte 6.79 milionë lekë, përkundër vlerës prej 2 milionë lekësh. Po ashtu, Komisioni ka konstatuar edhe që vlera e aplikuar për subjektin e rivlerësimit në këtë transaksion është më e ulët sesa ajo e përcaktuar nga Udhëzimi i Këshillit të Ministrave nr. 2/2007, për Entin Kombëtar të Banesave. Ky konstatim i Komisionit është bazuar edhe në krahasimin me kontratat e shitblerjes për apartamentet deri në 70 m² në të njëjtin objekt, të cilat i janë dërguar Komisionit nga ZVRPP-ja Tiranë.

26.3.2. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se edhe ky pretendim i subjektit të rivlerësimit është i pambështetur në dokumentacion. Në kushtet kur subjekti nuk paraqiti asnjë dokumentacion që të zhvendoste në kohë, qoftë edhe në mënyrë rrethore, ndërtimin e objektit minimalisht tre-katër vjet përpara hartimit të kontratës së sipërmarrjes, ky pretendim për kohën e ndërtimit në vitet 2001-2003 mbeti *deklarativ*. Nga aktet në fashikull nuk rezulton që subjekti të ketë përcjellë asnjë akt apo të dhënë për fillimin e punimeve të ndërtimit, përfundimin e tyre apo kryerjen e procedurave të kolaudimit dhe të dorëzimit të objektit që do të lejonin qoftë edhe në mënyrë rrethore që ndërtimi t'i atribuohet një kohe konsiderueshëm më të hershme nga kontrata e sipërmarrjes [2005] dhe e shitjes [në vitin 2015]. Nëse krahasohet vlera e blerjes së apartamentit me vlerën e tregut – sipas çmimit mesatar të shitblerjes në tregun e lirë prej 97 mijë lekë/m² për vitin 2007 – rezulton se shoqëria “{***}” i ka shitur subjektit një apartament me vlerë rreth 4.7 milionë lekë më pak se vlera e tregut. Për këtë shkak, konkluzioni i Komisionit se “{***}” ShPK ka aplikuar një çmim 71% më të ulët për subjektin e rivlerësimit është i drejtë. Ky çmim, për një pasuri të ndodhur në qendër të Tiranës⁴⁵, përveçse disa herë më i ulët sesa ai i tregut, rezulton më i ulët edhe se ai i referuar nga Këshilli i Ministrave EKB-së, për ndërtimet me fonde nga buxheti i shtetit në kushte të favorshme, për kategori të veçanta individësh, që nuk përfshin “[...] vlerat e: 1. rrjetit inxhinierik; 2. projektit; 3. studimit gjeologjik dhe sizmik; 4. lejes së ndërtimit; 5. truallit; 6. shpenzimeve operationale të EKB 4%[...].”⁴⁶.

26.3.3. Së fundmi, çmimi i aplikuar nga ndërtuesit për subjektin e rivlerësimit rezulton më i ulët dhe krahasuar me kontratat e paraqitura nga ZVRPP-ja Tiranë gjatë hetimit administrativ, më datë 02.05.2019. Nga analiza e kryer në Kolegj në funksion të këtij shkak ankimi, e cila u bazua në 24 kontrata shitjeje në të njëjtin objekt, bazuar në vlerën e tregut për vitet kur është kryer transaksioni, rezulton se çmimi i shitjes së apartamenteve me sipërfaqe të njëjtë (70 m²), nga shoqëria “{***}”, varion nga 29 mijë USD deri në 37.8 mijë USD. Ka kontrata shitjesh me vlera më të larta, deri në

⁴³ Duket sikur këtë krahasim subjekti e bën me vlerën e tregut të vitit 2007, ndërkohë kontratat e sjella janë lidhur në vite të ndryshme.

⁴⁴ Subjekti është familjar me konceptin e vlerës së tregut, pasi edhe ai vetë deklaroi se pasurinë apartament në rrugën “{***}” ia ka shitur vjehrrës me vlerë tregu mbi 2 herë më shumë se vlera e blerjes.

⁴⁵ Nga burime të hapura, rezulton afro 350 m larg nga selia e Këshillit të Ministrave, e në afërsi me Kryesinë e Kuvendit e ndërtesa të tjera të institucioneve kryesore dhe përfaqësive diplomatike të huaja.

⁴⁶ https://ekb.gov.al/wp-content/uploads/2015/07/udhzim_2.04.04.pdf.

125% të vlerës së tregut⁴⁷. Në përmbledhje, nga krahasimi me pasuritë me parametra të ngjashme në të njëjtën ndërtesë dhe me të njëjtën palën shitëse, subjekti ka blerë apartamentin me çmimin më preferencial kundrejt vlerës së tregut. Konkluzioni i Komisionit është i bazuar.

26.4. Subjekti i rivlerësimit kundërshton qëndrimin e Komisionit se subjekti ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit, kur ka marrë pjesë në gjykimin e një çështjeje penale në vitin 2016, ndaj z. A. Gj., personi i autorizuar nga shoqëria “{***}”, për shitjen e apartamentit, në kontratën e shitblerjes me palë subjektin e rivlerësimit, më datë 17.12.2015. Subjekti i rivlerësimit pretendon se z. A. Gj. ka qenë përfaqësues me prokurë i shoqërisë “{***}” vetëm për nënshkrimin e kontratës së shitblerjes së pasurisë objekt analize. Detyrimet ndaj shoqërisë për këtë pasuri janë shlyer që në vitin 2007, argumenton subjekti i rivlerësimit. Gjykimi i z. A. Gj. në Gjykatën e Apelit Durrës, në të cilin subjekti i rivlerësimit ka qenë kryesues, është zhvilluar në bazë të shortit të hedhur në gjykatë.

26.4.1. Në vendim, Komisioni ka konstatuar, ndër të tjera, që bashkëshortja e subjektit ka dhënë dorëheqjen nga një çështje civile ku ishte palë shoqërinë “{***}” ShPK. Nga ana tjetër, Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka qenë kryesues i trupit gjykues në Gjykatën e Apelit Durrës për një çështje penale, ku ka qenë në cilësinë e të pandehurit z. A. Gj. – ortak dhe administrator i shoqërisë “{***}” [shoqëria ndërtuese referuar pasurisë së parë, analizuar në rubrikën e numërtuar I më sipër] dhe palë në kontratën e porosisë për blerjen e pasurisë në analizë për llogari të shoqërisë “{***}” ShPK. Subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dorëheqjen nga kjo çështje. Z. A. Gj. ka qenë akuzuar për ndërtim të paligjshëm. Trupi gjykues i kryesuar nga subjekti i rivlerësimit, i cili ka kryer edhe funksionet e relatorit, ka dhënë vendim në favor të të pandehurit, z. A. Gj.. Komisioni ka konkluduar se subjekti ka qenë në konflikt interesi për të shqyrtuar çështjen penale në ngarkim të z. A. Gj., i cili ka qenë palë në kontratën e lidhur për blerjen e pasurisë në vlerën preferenciale prej 2 milionë lekësh.

26.4.2. Pasi analizoi sa më sipër, konkluzioni i Komisionit qëndron, por në kushtet kur për subjektin e rivlerësimit nuk është kryer vlerësimi i kriterit të aftësive profesionale, kjo çështje konsiderohet e ezauruar si më sipër. Nga aktet në fashikull, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se z. A. Gj. ka vepruar në emër të dy shoqërive – “{***}” ShPK dhe “{***}” ShPK. Me të parën, subjekti i rivlerësimit ka lidhur një kontratë sipërmarrjeje për apartamentin e analizuar në këtë rubrikë. Gjithashtu, nga aktet në fashikull, z. A. Gj. ka lidhur kontratën e shitjes së apartamentit në përdorim të babait të subjektit të rivlerësimit më datë 21.05.1999 [analizuar në rubrikën e numërtuar II në këtë arsyetim]. Z. A. Gj. vepron si administrator i shoqërisë “{***}” ShPK. Z. A. Gj. rezulton të ketë përfaqësuar dhe vepruar për llogari të shoqërisë “{***}” për vitet 2008-2015. Me këtë shoqëri, vetë subjekti i rivlerësimit ka pasur një marrëdhënie të gjatë, jo vetëm për shkak të blerjes së disa apartamenteve, por edhe si avokat për disa çështje gjyqësore. Me fjalë të tjera, marrëdhënia e subjektit të rivlerësimit me shoqërinë “{***}” dhe me z. A. Gj. individualisht, rezulton e gjatë. Leximi harmonik i dispozitave të nenit 5 të ligjit nr. 9367/2005⁴⁸ “Për parandalimin e konfliktit të interesave në

⁴⁷ Për secilën kontratë u bë krahasimi me vlerën e tregut që ka qenë në fuqi në vitin kur është lidhur kontrata e porosisë. Nga ky krahasim, nga 24 kontrata, vetëm 7 apartamente janë shitur nën vlerën e tregut, nga të cilat: 2 kontrata janë pothuajse sa vlera e tregut (1 % dhe 4 % më pak se vlera e tregut, diferencë që mund të vijë edhe nga konvertimi meqenëse janë kontrata në valutë), 4 kontrata janë midis 10 % dhe 39% më pak se vlera e tregut (konkretisht: 10%, 13%, 27%, dhe 39%). E vetmja kontratë me çmim preferencial 71% më të ulët se vlera e tregut, rezulton kontrata e subjektit të rivlerësimit. Kontrata me çmimin më të lartë, i përket një apartamenti të porositur në vitin 2006 dhe për të njëjtën sipërfaqe (70 m²). Kjo kontratë është lidhur me çmimin 102.000 EUR ose mbi 125 % se vlera e tregut.

⁴⁸ Neni 5 i ligjit përcakton që: “1. Interesat privatë të zyrtarit janë ata interesa që përputhen, përmbajnë, bazohen ose burojnë nga: (a) të drejta dhe detyrime pasurore të çdo lloji natyre; (b) çdo marrëdhënie tjetër juridiko-civile; (c) dhurata, premtime, favore, trajtime preferenciale; [...] angazhime në veprimtari private me qëllim fitimi ose çdo lloji veprimtarie, që krijon të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jofitimprurëse, [...] v) të njohura të miqësisë apo të armiqësisë; (e) angazhime të mëparshme, nga të cilat kanë buruar ose burojnë interesa të përmendur në shkronjat e mësipërme të këtij neni...”.

ushtrimin e funksioneve publike dhe i përcaktimeve të neni 17 të Kodit të Procedurës Penale⁴⁹, e vë subjektin e rivlerësimit në situatën e konfliktit të interesit. Për pasojë, subjekti i rivlerësimit nuk duhej të merrte pjesë në gjykimin e një çështjeje, ku palë ndërgjyqëse ishte një individ me të cilin subjekti ka pasur një marrëdhënie biznesi të vazhdueshme, në kapacitet privat dhe personal.

Automjeti [markë Audi A3] blerë në datën 8.11.2012, me vlerë 25.000 euro

27. Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka pasur pamundësi financiare për krijimin e kësaj pasurie në vitin 2012 dhe pas kalimit të barrës së provës nuk arriti të paraqesë prova dhe dokumentacion justifikues për të provuar të kundërtën e gjetjeve të konstatuara prej tij. Sipas Komisionit, të ardhurat nga shitja e apartamentit [të analizuar në rubrikën e numërtuar I] nuk janë provuar nga subjekti dhe, rrjedhimisht, nuk mund të konsiderohen si burim i ligjshëm për blerjen e një pasurie tjetër.

27.1. Subjekti i rivlerësimit kundërshton vlerësimin e Komisionit lidhur me pamjaftueshmërinë e burimeve në ankim. Sipas tij, si burim për blerjen e automjetit kanë shërbyer kursimet nga paga, në vlerën 200 mijë lekë dhe të ardhura të përfituara nga shitja e apartamentit [sipërcituar, pasuria e numërtuar I]. Argumentet mbi atë pasuri, referohen edhe në lidhje me këtë pasuri në ankim, për sa i përket të ardhurave të krijuara nga shitja e apartamentit vjehrrës, znj. L. V., si dhe burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie. Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë burimin e ligjshëm për krijimin e pasurisë, si dhe mundësinë financiare të vjehrrës për blerjen e apartamentit, nga shitja e të cilit subjekti deklaroi se ka nxjerrë të ardhurat për blerjen e automjetit.

27.2. Në vijim të analizës së akteve në fashikull, vendimit të Komisionit dhe pretendimeve të subjektit të rivlerësimit në ankim, trupi gjykues i Kolegjit rithekson sa është arsyetuar më sipër. Konkretisht, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar kalimin e shumës prej 8.8 milionë lekësh, si pasojë e shitjes së apartamentit të analizuar në rubrikën e numërtuar I, në llogari të tij dhe se ka lidhur kontratë fiktive për shitjen e këtij apartamenti, me qëllim justifikimin e krijimit të fondeve të deklaruara si burim për krijim pasurish, subjekti i rivlerësimit nuk arrin të provojë burimin e ligjshëm dhe për krijimin e kësaj pasurie. Për pasojë, trupi gjykues i Kolegjit e vlerëson të drejtë konkluzionin e Komisionit se subjekti ka pasur pamundësi financiare për blerjen e kësaj pasurie në vlerën -3.295.750 lekë.

IV. Bonot e thesarit në vlerën 3.000.000 lekë

28. Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka qenë në kushtet e pamundësisë financiare për krijimin e kësaj pasurie në vlerën (-) 2.705.114 lekë në vitin 2004 dhe se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të paraqesë prova dhe dokumentacion justifikues për të provuar të kundërtën e gjetjeve të konstatuara prej tij.

28.1. Subjekti i rivlerësimit parashtroi në ankim se gjysma e kësaj vlere [1.5 milionë lekë] janë kursime nga të ardhurat nga pagat e tij dhe e bashkëshortes, ndërsa pjesa tjetër [1.5 milionë lekë] janë depozituar në favor të vjehrrit, për pamundësi fizike të tij. Vjehri ka pasur të ardhura me burime të ligjshme nga qiradhënia e pronave, vlerën e përfutur nga vendimi gjyqësor, si dhe pensionet e tij dhe bashkëshortes. Subjekti, po ashtu parashtroi se Komisioni nuk e ka njohur me asnjë dokument, pasi ka konstatuar se vjehrra ka depozituar bono thesari në vitin 2004. Në mbështetje të argumenteve të tij, subjekti ka paraqitur në Komision një deklaratë noteriale të datës 09.01.2015 nga vjehrra, znj. L. V.. Sipas kësaj deklarate, për shkak të moshës së vjetër, bashkëshorti i ka dhënë

⁴⁹ Neni 17: "1. Gjyqtari ka për detyrë të heqë dorë nga gjykimi i çështjes konkrete: (a) kur ka interes në procedim ose kur një nga palët private ose një mbrojtës është debitor a kreditori tij, i bashkëshortit, bashkëjetuesit ose i fëmijëve të tij [...]; (e) kur ndodhet në një nga kushtet e papajtueshmërisë të parashikuara nga nenet 15 dhe 16; (ë) kur ekzistojnë shkaqe të tjera të rëndësishme njëanshmërie...".

subjektit të rivlerësimit 1.5 milionë lekë për të blerë bono thesari në Bankën e Shqipërisë. Kjo vlerë është kthyer.

28.2. Në analizë të vendimit të Komisionit, akteve në fashikull dhe shkaqeve të ankimit për këtë pasuri, trupi gjykues i Kolegjit konstaton që konkluzioni i Komisionit është i bazuar. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit, siç shtjellohet në vijim, nuk arritën të zhbëjnë sa konstatohet nga aktet që përbëjnë provë. Po ashtu, subjekti i rivlerësimit rezulton me mungesë burimesh të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie. Në vijim shtjellohen aktet dhe analiza e kryer nga trupi gjykues i Kolegjit për këtë shkak ankimi.

28.3. Subjekti ka deklaruar bono thesari në deklaratën e pasurisë [vetting], për periudhën 24.6.2004-24.12.2007, në vlerën 3.000.000 lekë, nga kursimet nga të ardhurat familjare dhe para të depozituara në favor të vjehrrit, z. N. V. “*për pamundësi fizike*”, në raportin 50-50%. Pjesa takuese: 1/4. Në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2009, subjekti nuk e ka deklaruar këtë pasuri, qoftë edhe si gjendje të likuiditeteve⁵⁰. Ndërkohë, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar për vitin 2004 detyrim financiar ndaj babait në shumën 1.5 milionë lekë. Në të njëjtën deklaratë, në seksionin “*Informacion konfidencial*”, ajo ka pasqyruar shumën 3 milionë lekë, llogari në Bankën e Shqipërisë. Në deklaratën e vitit 2006, bashkëshortja ka deklaruar pakësimin e shumës në 2.5 milionë lekë dhe tërheqjen e shumës prej 2.5 milionë lekësh në deklaratën e vitit 2007.

28.4. Nga vërtetimi i Bankës së Shqipërisë, sjellë si provë në ILDKPKI nga subjekti i rivlerësimit, rezulton se z. Arjan Balliu ka pasur llogari titulli në Bankën e Shqipërisë, si dhe ka pasur në zotërim bono thesari të qeverisë shqiptare, në vlerën nominale 3 milionë lekë. Gjithashtu, Banka e Shqipërisë ka informuar Komisionin, më datë 31.01.2019, se z. Arjan Balliu dhe znj. L. V. kanë llogari *cash*/titujsh për blerjen e bonove të thesarit të shtetit shqiptar pranë Bankës së Shqipërisë, prej vitit 2004.

28.5. Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur asnjë dokument për të provuar pretendimin se gjysma e vlerës i përket vjehrrit, qoftë për të provuar dhënien apo kthimin e kësaj e kësaj shume. E vetmja gjurmë e një vlere që përfshin z. N.V. është deklarimi i bashkëshortes në deklaratën periodike për vitin 2004, që gjithsesi referon një detyrim ndaj të atit në të njëjtën vlerë. Përkundër sa pretendon subjekti në ankim, në deklaratën e bashkëshortes për vitin 2004 nuk rezulton asnjë specifikim që të lidhë këtë shumë detyrimi me blerjen e bonove të thesarit apo të ndarjes në pjesë takuese midis vjehrrit dhe subjektit të rivlerësimit. Për pasojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit për pjesën e vjehrrit, mbeti deklarativ. Ky pretendim rezulton edhe jo bindës në kushtet kur nga aktet zyrtare të dërguara në Komision rezultoi se znj. L.V. [vjehrra] ka kryer personalisht të njëjtin investim në bono thesari në të njëjtën periudhë kohore, në vitin 2004. Mbi bazën e kësaj analize edhe deklarata noteriale e lëshuar nga znj. L.V. rezulton pa vlerë provuese, në kushtet kur bie ndesh me faktet dhe aktet zyrtare që dokumentojnë veprime, të cilat bien ndesh me sa pretendohet në deklaratën noteriale.

28.6. I pabazuar rezulton edhe pretendimi i subjektit të rivlerësimit në ankim, që Komisioni nuk e ka njohur me asnjë dokument, lidhur me konstatimin se vjehrra ka depozituar bono thesari në vitin 2004. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se ky fakt është referuar në rezultatet e hetimit të kryer në Komision, në faqet 11 dhe 12 të aktit. Në këto kushte, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka qenë në dijeni të sa është konfirmuar nga Banka e Shqipërisë, i është kaluar barrë prove për këto fakte dhe, për pasojë, kishte mundësinë të njëhej me dokumentacion e të paraqiste kundër argumentet e tij. Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit ka zgjedhur të mos njëhej me dokumentacionin, kërkesa në ankim rezulton e pakuptimë.

⁵⁰ Në zbatim të nenit 4, të ligjit nr. 9049/2003, në seksionin që i dedikohet deklarimit të interesave privatë, kërkohet nga deklaruesit të përshkruajnë hollësisht: “[...] burimet e origjinës apo të krijimit të çdo lloj pasurie, të paluajtshme dhe të luajtshme, likuiditete, të regjistruara ose jo në regjistrat publikë”.

28.7. Për sa i përket pamjaftueshmërisë së burimeve financiare të ligjshme për të krijuar këtë pasuri edhe nga analiza financiare e kryer në Kolegj, subjekti i rivlerësimit rezulton me mungesë burimesh. Në ndryshim nga vlera prej (-) 2.705.114 lekësh e përlllogaritur në Komision, në analizën e kryer në Kolegj, pamundësia u përlllogarit në një vlerë pak më të ulët me (-) 2.668.628 lekë. Diferenca mes dy shifrave vjen nga korigjimi i vlerës së të ardhurave. Në analizën e Kolegjit u ekstraktuan nga dokumentacioni në dosje pagat konkrete të përfituara nga subjekti dhe bashkëshortja gjatë kësaj periudhe kohore, ndërkohë që në analizën e Komisionit, ky zë është përlllogaritur në mënyrë përpjesëtimore nga të ardhurat vjetore.

28.8. Në përfundim të sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit konkludoi që për pasurinë bono thesari subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e saj, sipas përcaktimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “a” dhe “b” e ligjit nr. 84/2016 dhe se konkluzioni i Komisionit, lidhur me këtë pasuri, është i bazuar.

V. *Llogaria bankare në vlerën 550.375 lekë, në “Raiffeisen Bank”*

29. Komisioni ka konkluduar se për këtë pasuri të deklaruar në deklaratën e pasurisë [vetting], subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues që provon se ky likuiditet është krijuar nga paga dhe shitja e apartamentit në Tiranë. Gjithashtu, Komisioni ka arritur në përfundimin që subjekti nuk ka deklaruar raportin mes të ardhurave nga paga kundrejt atyre nga shitja e apartamentit, për të provuar burimin e krijimit të këtij likuiditeti. Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të paraqesë prova dhe dokumentacion justifikues për të provuar të kundërtën e gjetjeve të konstatuara prej tij.

29.1. Subjekti i rivlerësimit parashton në ankim se burimi i krijimit janë kursimet familjare nga pagat, një pjesë e të cilave kanë prejardhje nga gjendja *cash* në banesë, ndërsa pjesa tjetër nga shitja e apartamentit në shumën 8.8 milionë lekë vjehrrës [të analizuar në rubrikën e numërtuar I më sipër]. Këto vlera mbaheshin së bashku *cash* në banesë. Sipas subjektit, gjendja e kësaj llogarie është krijuar nga paga të patërhequra dhe pjesa tjetër nga një depozitim prej 400 mijë lekësh në datën 14.10.2016, që kanë qenë kursime nga pagat dhe nga shitja e apartamentit të cituar më lart, të cilat mbaheshin së bashku *cash* në banesë. Detyrimi për deklarimin e gjendjes *cash* në banesë, sipas subjektit, ka lindur në vitin 2014.

29.2. Në analizë të akteve në fashikull, vendimit të Komisionit dhe pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se subjekti i rivlerësimit ka qenë kontradiktor në deklaratimet e gjendjes së likuiditeteve *cash* ndër vite. Për pasojë, pretendimi që llogaria bankare ka për burim të ardhurat nga paga [dhe shitja e apartamentit], rezulton i pabazuar. Po ashtu, për sa i përket gjendjes *cash* të pretenduar të krijuar pjesërisht nga shitja e apartamentit, në vazhdim të arsyetimit dhe qëndrimit të Kolegjit për shitjen e kësaj pasurie, shtjelluar më sipër në rubrikën e numërtuar “I” dhe paragrafët përkatës, të këtij vendimi, pa përsëritur sa është arsyetuar, për fiktivitetin e veprimit juridik të shitjes së apartamentit, trupi gjykues i Kolegjit risjell në vëmendje konkluzionin që subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë kalimin e shumës 8.8 milionë lekë për llogari të tij. Për pasojë, kjo e ardhur e pretenduar nga shitja e apartamentit nuk mund të ketë shërbyer si burim për krijimin e llogarisë bankare. Konkluzioni i trupit gjykues për këtë pasuri shtjellohet në vijim.

29.3. Nga aktet në fashikull rezulton se kjo pasuri është deklaruar si vijon në kohë të ndryshme:

a. Në deklaratën e pasurisë [vetting], dorëzuar më datë 27.01.2017, subjekti ka deklaruar këtë llogari bankare [me numrin përkatës] dhe gjendjen në vlerën 550.375 lekë, në “Raiffeisen Bank”. Burimi i deklaruar i krijimit janë “[...] të ardhura nga pagat dhe shitja e pasurisë së paluajtshme [...] të apartamentit 1+1+aneks, me sip. 70,8 m², Tiranë”. Nuk është saktësuar raporti specifik/vlera që është përdorur nga secili prej burimeve.

b. Në deklaratën periodike vjetore për vitin 2016, subjekti ka deklaruar llogarinë bankare në vlerën përkatëse [519.929 lekë] dhe numrin e llogarisë në “Raiffeisen Bank”. Burim krijimi

janë deklaruar “*të ardhura nga pagat dhe kursimet familjare*”. Me fjalë të tjera, në këtë deklaratë, të plotësuar në datën 23.03.2017, afro dy muaj pas dorëzimit të deklaratës *vetting*, subjekti nuk ka deklaruar si burim krijimi të llogarisë bankare të ardhurat nga shitja e apartamentit.

c. Për sa i përket gjendjes *cash*, në deklaratat periodike të dorëzuara as subjekti i rivlerësimit dhe as bashkëshortja nuk rezultojnë të kenë deklaruar gjendje/shtesa/pakësime të gjendjes së likuiditeteve *cash* në banesë apo në sistemin bankar, për asnjë vit deklarimi deri në vitin 2013. Ky konstatim gjen zbatim edhe për vitin 2012, që përkon me kohën kur është hartuar kontrata e shitjes së apartamentit – në deklaratën periodike vjetore për atë vit, si subjekti i rivlerësimit, ashtu edhe bashkëshortja nuk kanë deklaruar gjendje *cash* në banesë si rezultat i shitjes së apartamentit.

ç. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar për herë të parë gjendje *cash* në vitin 2014. Konkretisht, në seksionin që i dedikohet ndryshimit të pasurive dhe burimit përkatës, subjekti ka deklaruar shtuar nga kursimet vjetore gjendja *cash* në banesë – 200.000 lekë. Gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti ka deklaruar se gjendja *cash* në banesë, në vitin 2014, ka qenë në shumën 1.5 milionë lekë, aq sa e lejonte edhe ligji i kohës. Po ashtu, në pyetësorë, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se këto kursime janë krijuar nga vlera që mbeti nga shitja e apartamentit vjehrrës dhe pas blerjes së automjetit prej 25.000 euro. Subjekti ka pretenduar se deklarimi i gjendjes *cash* nuk ka qenë detyrim ligjor në atë kohë.

d. Në deklaratën periodike për vitin 2015, subjekti ka deklaruar pakësim të gjendjes *cash* me 700 mijë lekë, pa shpjegime të tjera.

e. Në deklaratën periodike për vitin 2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjendje *cash* në vlerën 1 milion lekë, me burim *kursimet familjare dhe të ardhurat nga shitja e apartamentit [...]*.

29.4. Nga analiza e deklarimeve të sipër referuara, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se subjekti ka kryer deklarime kontradiktore lidhur me gjendjen *cash* në vite dhe, për pasojë, pretendimi se kjo gjendje ka qenë burimi i krijimit të llogarisë bankare dhe është krijuar nga të ardhurat nga paga dhe shitja e apartamentit, gjendet i pabazuar. Po ashtu, në vazhdim të arsyetimit për fiktivitetin e shitjes së kësaj pasurie, shtjelluar në detaj më sipër, mbështetur pjesërisht edhe në konstatimin që kalimi i shumës prej 8.8 milionë lekësh për llogari të subjektit të rivlerësimit, nuk u provua në asnjë formë, afekton drejtpërdrejt negativisht në drejtim të mundësisë së ekzistencës së të ardhurave për të krijuar llogarinë bankare objekt analize.

29.5. Bazuar në deklarinë e subjektit të rivlerësimit se balanca e llogarisë në fund të vitit 2016 është krijuar prej vlerës rreth 100 mijë lekë, që është derivat i pagave të patërhequra dhe një depozitim prej 400 mijë lekësh më datë 14.10.2016, në Kolegj u krye analiza financiare në funksion të kontrollit për mundësinë e krijimit të tyre me burime të ligjshme. Në këtë analizë, trupi gjykues vëren së pari se shpenzimet e deklaruara janë ato që përkojnë me vlera të caktuara që nuk përfaqësojnë e përfshijnë të gjitha shpenzimet familjare. Në këtë logjikë, nuk mund të derivohet se nga zbritja e shpenzimeve nga të ardhurat, vlera e mbetur përbën kursim. Neni 4 i ligjit nr. 9049/2003 ka përcaktuar qartë se objekt deklarimi është gjendja e likuiditeteve në 31 dhjetor të vitit pararendës⁵¹. Në vijim të këtyre normave ligjore, trupi gjykues i Kolegjit ka tashmë një jurisprudencë të gjerë në të cilën është theksuar se në analizën financiare për periudhën e rivlerësimit

⁵¹ Neni 4 i ligjit nr. 9049/2003, pika 1 parashikon: “Subjektet [...] deklarojnë [...] gjendjen deri në 31 dhjetor të vitit paraardhës të interesave privatë [...], burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare, si më poshtë [...]; (d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në *cash* jashtë sistemit bankar [...] në lekë ose në valutë të huaj [...]”.

merret në konsideratë deklarimi i gjendjeve *cash*, sipas deklaratave periodike dhe jo sipas deklaratimeve të pyetësorëve gjatë procesit të rivlerësimit⁵².

29.6. Në përmbledhje të sa më sipër, rezulton se vlera prej 400 mijë lekësh, e cila sipas subjektit të rivlerësimit ka shërbyer për krijimin e gjendjes së llogarisë bankare objekt i kësaj analize, është e pambuluar me burime të ligjshme në kuptimin e ligjit nr.84/2016. Në analizë të fakteve dhe rrethanave të shtjelluara më sipër, trupi gjykues i Kolegjit arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të krijuar këtë pasuri, parashikuar në nenin 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

VI. Gjendja *cash* në vlerën 1.000.000 lekë, në banesë

30. Komisioni ka referuar se mbërriti në një konkluzion të njëjtë me atë të ILDKPKI-së për pasaktësi në deklarime, duke sjellë në vëmendje që subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar gjendje *cash* në deklaratën periodike për vitin 2012 dhe 2013, deklaratat periodike kanë qenë kontradiktore dhe që pas kalimit të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të paraqesë prova dhe dokumentacion justifikues për të provuar të kundërtën e gjetjeve të konstatuara nga Komisioni. Për herë të parë është deklaruar gjendje *cash* në banesë për vitin 2014, në vlerën 200.000 lekë. Në deklaratën periodike të vitit 2015, subjekti ka deklaruar pakësim të gjendjes *cash* në banesë në shumën 700.000 lekë. Në deklaratat periodike në vijim nuk është deklaruar gjendje *cash* jashtë sistemit bankar, në banesë. Së fundmi, Komisioni ka argumentuar se si burim i krijimit të shumës së deklaruar në deklaratën e pasurisë [objekt i kësaj analize] nuk mund të jenë të ardhurat e vitit, të cilat janë më të ulëta, krahasuar me shpenzimet e vitit.

30.1. Siç është përmbledhur më sipër gjerësisht, subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin për fiktivitet të kontratës së shitjes, sikurse edhe konkluzionin e Komisionit për deklarime kontradiktore ndër vite, mbi bazën e të cilave nuk provohet ekzistenca e gjendjes së likuiditeteve jashtë sistemit bankar. Ai argumenton se termi *cash* u vendos detyrimisht si pjesë e deklarimit periodik vetëm pas miratimit të ligjit nr. 45/2014, i cili ndryshoi ligjin nr. 9049/2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”. Edhe nga përmbajtja e formularëve për deklarimet vjetore në periudhën 2003-2014, sipas subjektit të rivlerësimit, nuk është kërkuar deklarimi i vlerës *cash* jashtë sistemit bankar. Gjendja *cash* në banesë në vitin 2014 ka qenë në shumën 1.500.000 lekë, aq sa e lejonte ligji i kohës. Në deklaratat e viteve 2014-2015 ka pasqyruar shtesat dhe pakësimet e gjendjes *cash* në banesë, pasi ka vlerësuar se kështu duhej të pasqyrohej formulari. Në deklaratën vjetore 2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjendje *cash* në vlerën 1 milion lekë.

30.2. Pasi shqyrtoi aktet në fashikull dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit konstatoi se edhe për këtë pasuri, sikurse edhe për dy të tjerat e sipër referuara, krijimi i të cilave afektohet nga konkludimi për kontratë fiktive shitjeje të pasurisë së analizuar në rubrikën e numërtuar “I” [apartament 70,8 m²], subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme, sipas përcaktimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016. Po ashtu, siç është arsyetuar më sipër në lidhje me mungesën e deklarimit të gjendjes së likuiditeteve jashtë sistemit bankar në deklaratat periodike vjetore, edhe në rastin e kësaj pasurie, në cilindo këndvështrim të analizuar, pretendimet e subjektit të rivlerësimit janë të pabazuara. Ky përfundim i trupit gjykues mbështetet në analizën që shtjellohet në vijim.

30.3. Së pari, në deklaratën e pasurisë *vetting* subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjendje *cash* në vlerën 1 milion lekë me burim të krijimit *kursimet familjare* dhe të *ardhurat nga shitja e apartamentit* [me të dhënat përkatëse – 1+1, me sipërfaqe 70,8 m², ruga “{***}”, pall. {***}, shk. {***}, ap. {***}, Tiranë.] Në deklaratën e vitit 2014, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shtesë nga

⁵² Ndër të tjera në vendimet që i përkasin subjekteve të rivlerësimit Xh. Z. [JR nr. 19/2019] dhe D. P. [JR. 27/2020].

kursimet vjetore gjendja cash në banesë 200.000 lekë, ndërsa në deklaratën e vitit 2015 ka deklaruar pakësuar gjendja cash në banesë 700.000 lekë. Në pyetësorë, subjekti ka deklaruar se në vitin 2014, gjendja cash në banesë ka qenë në shumën 1.500.000 lekë, aq sa e lejonte ligji i kohës, në vitin 2015 ka qenë 800.000 lekë dhe në vitin 2016 ka qenë 1.000.000 lekë.

30.4. Trupi gjykues i Kolegjit së pari vëreu se pretendimi i subjektit të rivlerësimit, se nuk kishte detyrim për deklarimin e gjendjes *cash* para ndryshimeve ligjore të vitit 2014, nuk mbështetet në ligj. Siç është arsyetuar më sipër, lidhur me llogarinë bankare, në seksionin e numërtuar “V” dhe poshtëshënimin nr. 51, ligji nr. 9049/2003, nëpërmjet nenit 4 dhe formulari i deklarimit të interesave private në faqen 3, para ndryshimeve të vitit 2014, kanë pasur të përcaktuar qartë detyrimin e zyrtarit deklarues të deklarojë gjendjen e parave *cash*. Ndryshimet që solli ligji nr. 45/2014 kishin si qëllim përcaktimin e vlerës maksimale *cash* që subjektet deklaruese për herë të parë mund të mbanin dhe të deklaronin jashtë sistemit bankar, me qëllim shmangien e informalitetit, fiktivitetit dhe rritjen e transparencës.

30.5. Nga sa është cituar më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vëren se pavarësisht disa deklarimeve në disa vite për ndryshime të gjendjes *cash*, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar qartë gjendjen e kësaj pasurie, në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi. Trupi gjykues i Kolegjit ka në konsideratë edhe sa është argumentuar në çështje të mëparshme në analizë të pretendimeve për gjendjen *cash* jashtë sistemit bankar të padeklaruara qartë dhe në mënyrë konsistente ndër vite, duke u dhënë peshë deklaratave periodike vjetore⁵³ nën dritën e përcaktimit të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, për vlerën provuese që paraqesin deklaratimet ndër vite në procesin e rivlerësimit. Në përmbledhje të sa më sipër, pretendimet e subjektit të rivlerësimit në pyetësorë, për vlera likuiditetesh të padeklaruara ndër vite e që nuk përputhen me deklaratat periodike vjetore, nuk u vlerësuan me vlerë provuese. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit nuk ka rritur të provojë ligjshmërinë dhe mjaftueshmërinë e burimeve të krijimit të pasurisë 1 milionë lekë *cash* në banesë.

30.6. Në kushtet kur si është argumentuar edhe për llogarinë bankare në “Raiffeisen Bank” më sipër [dhe automjetin], të ardhurat e pretenduara nga shitja e apartamentit nuk mund të kenë shërbyer për krijimin e gjendjes *cash* në banesë. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit konkludon se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të krijuar këtë pasuri, sipas nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

VII. Apartamenti në {***}, Kavajë⁵⁴

31. Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, nuk arriti të paraqesë prova dhe dokumentacion justifikues për të provuar të kundërtën e gjetjeve të konstatuara prej tij, sipas të cilave subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë lidhur me këtë pasuri dhe që: (i) bashkëshortja e subjektit, sipas kontratës së sipërmarrjes të datës 30.10.2004, vepron si pronare vetme e truallit, cilësi që bie ndesh me situatën ligjore të pronësisë; (ii) mungesë dokumentacioni provues për blerjen e truallit dhe për burimin e ligjshëm të blerjes së tij; (iii) nuk është dokumentuar përfitimi në total nga sipërfaqja e ndërtimit, nga personi i lidhur, znj. L. V., prej shoqërive ndërtuese “{***}” dhe “{***}”. Vjehrra e subjektit ka përfituar katër njësi, ndërkohë që sipas kontratës së shkëmbimit të truallit, duhet të përfitonte vetëm dy njësi ndërtimore nga shkëmbimi i truallit; (iv) nuk u vërtetua se kjo pasuri është përfituar nga shkëmbimi i truallit. Sipas kontratës, pasuria është përfituar me anë të blerjes, në shumën 4.500.000 lekë. Vjehrra e subjektit të rivlerësimit rezultoi me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për shumën 4.500.000 lekë; (v) përfitimi i drejtpërdrejtë i kësaj pasurie nga bashkëshortja e subjektit është bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore që rregullojnë marrëdhëniet për fitimin e pronësisë. Është deklaruar se pronare e

⁵³ Me fokus arsyetimin e vendimit në çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit D. P., paragrafët 19.4.vii dhe 21.1, në https://kpa.al/wp-content/uploads/2020/12/Vendimi_Dritan-Peka_i_anonimizuar_per_web.pdf

⁵⁴ Me sipërfaqe 123 m², fituar nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr. {***}, datë 26.11.2007 dhe kontratës së sipërmarrjes nr. {***} rep., datë 13.1.2004, si dhe kontratës së sipërmarrjes nr. {***} rep., datë 30.10.2004.

truallit ku është ndërtuar pasuria në fjalë ka qenë nëna e bashkëshortes së subjektit. Kalimi i pronësisë së apartamentit direkt te bashkëshortja e subjektit është bërë në kundërshtim me dispozitat e Kodit Civil dhe legjislacionit në fuqi. Me këto veprime janë shmangur detyrimet financiare përkatëse në buxhetin e shtetit. Komisioni ka vlerësuar se kjo pasuri është përfituar si rezultat i blerjes dhe e ka konsideruar përfitimin e drejtpërdrejtë të pasurisë nga bashkëshortja e subjektit si një veprim i kryer për të shmangur detyrimet përkatëse financiare në buxhetin e shtetit, por pa specifikuar llojin e detyrimit apo mënyrën se si është shmangur.

31.1. Në ankim, subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit, lidhur me këtë pasuri, duke parashtruar se: (i) bashkëshortja nuk ka vepruar si pronare e truallit. Në cilësinë e pronares së truallit, nëna e bashkëshortes ia ka caktuar që në fillim pjesën takuese së bijës. Nëna e bashkëshortes ka lidhur kontratë sipërmarrjeje me shoqërinë “{***}”, më datë 13.01.2004, për shkëmbimin e truallit me sipërfaqe ndërtimi. Në datën 30.10.2004, me të njëjtën shoqëri ka nënshkruar kontratën e dytë të sipërmarrjes. Kontrata e dytë e porosisë, e lidhur nga bashkëshortja me shoqërinë “{***}” më datë 30.10.2004, është bazuar në kontratën fillestare të datës 13.01.2004 të lidhur nga nëna e saj me këtë shoqëri. Cilësimi i bashkëshortes si pronare trualli është një lapsus i noterës në kontratën e sipërmarrjes së datës 30.10.2004; (ii) sipas kontratave, vjehrra do të përfitonte 2 (dy) apartamente dhe një garazh në këmbim të truallit, si dhe apartamentin që i ka dhënë bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit. Në kontratën fillestare të datës 13.01.2004, rezulton se bashkëpronarët e tjerë të truallit kanë përfituar secili 4 (katër) njësi, për të njëjtën sipërfaqe trualli të dhënë për ndërtim; (iii) vlera prej 4.500.000 lekësh, e parashikuar në kontratën e blerjes më datë 26.11.2007, nuk është paguar realisht as nga vjehrra dhe as nga bashkëshortja, pasi kjo kontratë ka qenë pjesë e shkëmbimit të truallit me sipërfaqe ndërtimore. Kalimi i pronësisë është bërë me anë të kontratës së shitjes pasi pallatin e ka përfunduar një shoqëri e ndryshme nga ajo me të cilën ishte lidhur kontrata e sipërmarrjes. Ishte e pamundur ligjërisht të lidheshin kontrata dhurimi apo shkëmbimi.

31.2. Në analizë të akteve në fashikull dhe pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit konstatoi se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë mënyrën e fitimit të pronësisë së kësaj pasurie dhe të burimeve të ligjshme që kanë shërbyer për këtë qëllim, nën dritën e përcaktimeve të nenit D, pikat 1 dhe 3 dhe nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit rezultuan të pambështetura në dokumentacion dhe të pabazuara. Për rrjedhojë, konstatimet mbi të cilat bazohet konkluzioni i Komisionit janë të drejta. Ky përfundim i trupit gjykues mbështetet në analizën që shtjellohet në vijim.

31.3. Sipas deklaratës së pasurisë *vetting*, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka deklaruar këtë pasuri me detajet përkatëse [shih poshtëshënimin nr. 54], përfshirë edhe të dhënat e kontratës së shitblerjes [datë 26.11.2007] dhe kontratat e sipërmarrjes [në datat 13.1.2004 dhe 30.10.2004], si dhe [...] vlerën 4.500.000 lekë. Pjesa takuese: 100 %. [...]. Burim i krijimit është deklaruar përfitimi nga znj. L. V. [nëna e bashkëshortes së subjektit], si ish-pronare e truallit.

31.4. Sipas certifikatës së pronësisë së datës 28.05.2001, rezulton se vjehrra e subjektit të rivlerësimit ka qenë pronare e një trualli 600 m², në {***}, Kavajë. Në datën 13.01.2004, sikurse edhe bashkëpronarët e tjerë të truallit, ajo ka nënshkruar një kontratë sipërmarrjeje [me nr. {***} rep.], me shoqërinë “{***}” ShPK. Sipas kësaj kontrate, në këmbim të truallit të dhënë për ndërtim investitorëve, të gjithë bashkëpronarët do të përfitonin 26% të sipërfaqes totale të ndërtimit. Sipas një kontrate të dytë sipërmarrjeje [me nr. {***}] të lidhur në datën 30.10.2004, nëntë (9) muaj më pas, po ashtu me shoqërinë “{***}” ShPK, znj. L. V., do të përfitonte nga ndërtimi në truallin objekt kontrate: dy apartamente 1+1 dhe ambiente të tjera ndihmëse, me sipërfaqe ndërtimore 81, 5 m² secili [gjithsej 163 m² sipërfaqe ndërtimore] dhe një garazh me sipërfaqe 18,2 m².

31.5. Bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, znj. R. B., ka lidhur një kontratë sipërmarrjeje, po ashtu më datë 30.10.2004, me të njëjtën shoqëri ndërtuese, “{***}” ShPK, sipas së cilës do të përfitonte një apartament 2+1 dhe ambiente të tjera ndihmëse, me sipërfaqe ndërtimore 118,5 m², në korpusin A. Në datën 26.11.2007, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka lidhur kontratë shitblerjeje të apartamentit, të referuar me sipërfaqe totale 123 m² me shoqërinë “{***}”, me çmimin 4.500.000 lekë. Palët në kontratë kanë specifikuar se shuma është likuiduar nga nëna e bashkëshortes së subjektit, znj. L. V. . Në kontratë është deklaruar edhe që [...] *Kjo kontratë shitjeje realizohet për arsye se nëna e blerëses është me cilësinë e pronares të truallit mbi të cilën është ndërtuar apartamenti objekt i kësaj kontrate, për arsye të mospërputhjes të pozicionit të truallit të blerëses me godinën e ndërtuar nga shoqëria “{***}”(shitësi).[...].*

31.6. Më datë 05.02.2009, znj. L. V., ka nënshkruar një deklaratë noteriale për heqje dorë nga pronësia, meqenëse sipërfaqen ndërtimore, sipas marrëveshjes që kishte me shoqërinë “{***}”, e ka marrë nga shoqëria “{***}”. Ndër të tjera, në këtë deklaratë, nëna e bashkëshortes së subjektit, duke referuar *kontratën e sipërmarrjes së datës 13.01.2004*, ka deklaruar nga ndërtimi *do të përfitoja [...] 26% të sipërfaqes ndërtimore, dhe nga ky 26% unë kam përfituar, sipas kontratës së sipërmarrjes me nr. {***}, datë 30.10.2004, dy apartamente banimi me sipërfaqe të përgjithshme ndërtimore 163 metër katror [...].*

31.7. Nga sa më sipër, nga aktet në fashikull rezulton se të gjitha pretendimet e subjektit të rivlerësimit për mënyrën e fitimit të kësaj prone nga bashkëshortja janë të pambështetura në prova. Nëna e bashkëshortes ka rënë dakord dhe ka përfituar 26% të sipërfaqes ndërtimore, e barasvlefshme me 163 m², fakt të cilin ajo e ka pranuar në vitin 2009 në marrëdhënien juridike të krijuar me ndërtuesin që ka marrë përsipër detyrimet dhe të drejtat e ndërtuesit të mëparshëm. Për pasojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit për prishmëritë për 4 (katër) apartamente, i cili nuk u mbështet në asnjë dokument dhe bie ndesh me sa ka disponuar vetë znj. L. V. në dokumentacionin ligjor të kohë, nuk ishte bindës.

31.8. Ky konkluzion përputhet edhe me sa është parashikuar në kontratën që shoqëria “{***}” ShPK ka lidhur me shoqërinë “{***}” ShPK, në datë 20.12.2004, ku palët kanë rënë dakord që nënsipërmarrësi (“{***}”) [...] *merr përsipër të njohë dhe të plotësojë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga kontrata që sipërmarrësi ka bërë me pronarët e truallit, qoftë si shifër 26% të sipërfaqes së ndërtimit, qoftë edhe për zgjedhjen faktike të apartamenteve në të dy korpuset [...].*

31.9. Nga ky specifikim kontraktor rezulton qartë, jo vetëm që shoqëria “{***}” ShPK ka ruajtur të drejta dhe detyrime të njëjta kundrejt pronarëve si shoqëria e parë, por edhe që marrëdhënia me pronarët e truallit është marrë përsipër të finalizohet me kontratën e shkëmbimit dhe jo me kontrata fiktive shitjeje, siç pretendon subjekti i rivlerësimit. Për pasojë, pretendimi i subjektit se e vetmja formë për kalimin e pronësisë është kontrata e shitjes, meqenëse pallatin e ka përfunduar një shoqëri e ndryshme nga ajo me të cilën ishte lidhur kontrata e sipërmarrjes, rezulton i pambështetur në akte dhe në dispozitat e Kodit Civil për fitimin e pronësisë.

31.10. Pretendimi i subjektit në përgjigje të barrës së provës se për të njëjtat arsye, ato që lidhen me zëvendësimin e ndërtuesit, ai dhe bashkëshortja janë *gjendur [...] Në mungesë absolute të parashikuar nga legjislacioni civil të përpilimit dhe nënshkrimit të kontratave të sipërmarrjes dhe dhurimit kemi zgjedhur si rrugë ligjore mënyrën e vetme të kalimit të pronësisë, kontratën e shitjes, e cila parashikohet nga neni 705, i Kodit Civil [...] rezulton edhe alogjik. Jo vetëm që bashkëshortja e subjektit kishte lidhur kontratë sipërmarrjeje, në tetor 2004, por edhe kontratë shitjeje në vitin 2007. Kodi Civil përmban dispozita që rregullojnë jo vetëm kontratat e sipërmarrjes [në nenet 850-876], sikurse edhe ato të dhurimit [nenet 761-771].*

31.11. Është po ashtu alogjik pretendimi i subjektit në ankim se kjo pasuri fitohet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga pasuria *trashëgimore* e të ëmës, në kushtet kur nëna e bashkëshortes është

gjallë. Nëse apartamenti do të ishte pjesë e pasurisë që ka përfituar nëna, kalimi i pronësisë të vajza (bashkëshortja e subjektit) duhet të realizohej me anë të kontratës së dhurimit.

31.12. Për sa më sipër, nuk qëndron pretendimi se në mungesë të një parashikim ligjor subjekti (bashkëshortja) ka qenë i detyruar të lidhte një kontratë fiktive shitjeje. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se subjekti i rivlerësimit nuk arrin të argumentojë bazuar në ligj dhe në prova se apartamenti në pronësi të bashkëshortes ka ardhur si pjesë e pasurisë që nëna e saj ka përfituar nga dhënia për ndërtim e truallit në pronësi. Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë, në kuptim të përcaktimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, duke mos provuar qartë dhe bindshëm mënyrën sesi apartamenti ka ardhur në pronësi të personit të lidhur. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit që mënyra e përfitimit – si pjesë e pasurisë që nëna e personit të lidhur ka përfituar nga trualli dhënë prej saj për ndërtim – nuk mbështeten nga dokumentacioni i administruar në procesin e rivlerësimit.

31.13. Përpos sa më sipër, trupi gjykues vëren se pasuritë e fituara nga nëna e bashkëshortes dhe bashkëshortja e subjektit janë të ndryshme për nga të dhënat dhe, konkretisht: sipërfaqja totale e përfituar nga nëna e bashkëshortes është 163 m² dhe garazh 18,5 m², dy apartamente. Pasuria e fituar nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit është 123 m².

31.14. Në Kolegj u krye analiza financiare për verifikimin e mjaftueshmërinë së burimeve të nënës së bashkëshortes për blerjen e apartamentit në vlerën 4.500.000 lekë, sipas deklaramit që është bërë në kontratën e shitblerjes se pagesa është kryer nga nëna e bashkëshortes. Nga kjo analizë rezulton se investimet e L. dhe N. V. për vitin 2007 kanë qenë tepër të larta dhe, për këtë arsye, arrihet në përfundimin se ajo rezulton në pamundësi financiare të kryerjes së pagesës prej 4.500.000 lekësh.

31.15. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit, për pasurinë apartament me sip. 123 m², ndodhur në {***}, Kavajë, në pronësi të bashkëshortes, çmon se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë mënyrën e fitimit të pronësisë së kësaj pasurie dhe të burimeve të ligjshme që kanë shërbyer për këtë qëllim, të deklaruara në deklaratën *vetting*, nën dritën e përcaktimeve të nenit D, pikat 1 dhe 3, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 33, pika 5, shkronjat “a” dhe “b” e ligjit nr. 84/2016.

VIII. Llogaria në emër të bashkëshortes, me vlerë 500.106 lekë, në “Credins Bank”

32. Në analizën financiare të kryer gjatë hetimit administrativ dhe në vendim, ndër të ardhurat që janë deklaruar si burim krijimi i kësaj pasurie, Komisioni ka përfshirë 1/3 e shumës së përfituar nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor të Gjykatës së Rrethit Durrës, meqenëse kjo është pjesa takuese, ekuivalenti i 217.397 lekë [1/3 * 652.190]. Sipas Komisionit, deklarimi i bërë për krijimin e shumës prej 500.106 lekë nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor nuk është i saktë. Bazuar në vendimin gjyqësor, pjesa përfituese e babait të bashkëshortes së subjektit ka qenë në shumën 652.190 lekë, shumë e cila u kalon trashëgimtarëve: bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, nënës dhe vëllait të saj.

32.1. Subjekti i rivlerësimit parashtron në ankim se në emër të trashëgimtarëve të vjehrrit ka kaluar gjithë shuma e ekzekutimit të vendimit gjyqësor prej 1.956.570 lekësh, pasi dy palët e tjera në procesin gjyqësor kanë rënë dakord të mos kenë asnjë përfitim. Sipas subjektit, përfitimi i gjithë shumës prej familjes së bashkëshortes ka ardhur pasi prona që ka qenë në konflikt gjyqësor i është lënë prej trashëgimtarëve vetëm babait të bashkëshortes [të ndjerit, N. V.].

32.2. Në analizë të pretendimit të subjektit të rivlerësimit dhe akteve në fashikull, trupi gjykues i Kolegjit vëren se përlllogaritja e kryer nga Komisioni, bazuar në veprimet juridike të ndërmarra nga bashkëtrashëgimtarët, sipas dokumentacionit ligjor në fashikull, është e bazuar. Dorëheqja e trashëgimtarëve të tjerë nuk provohet nga aktet e kohës. Ky konkluzion i trupit gjykues të Kolegjit bazohet në analizën e shtjelluar në vijim.

32.3. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka deklaruar llogari bankare në “Credins Bank”, me të ardhura të krijuara nga ekzekutimi i vendimit Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës të datës 12.11.2007 dhe sipas urdhrit të ekzekutimit të së njëjtës gjykatë që mban datën 27.3.2013, në shumën 652.190 lekë.

32.4. Nga aktet në fashikull rezultojnë faktet që vijojnë:

a. Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor i sipërcituar [nr. {***}], datë 12.11.2007, padia në gjykatë, si dhe ankimi i vendimit të shkallës së parë në apel dhe në Gjykatën e Lartë, referon se të tri paditësit, z. N.V., znj. M. H. dhe z. A. V., kanë paraqitur kërkesa dhe janë sjellë si bashkëpronarë. Nga vërtetimi i pronësisë i hipotekës Durrës, që mban datën 23.11.1992, vërtetohet se në bazë të testamentit të regjistruar në vitin 1961, z. E. V. i ka lënë trashëgim djalit N. V. një dyqan në lagjen nr. 2, Durrës, në bashkëpronësi me J. M..

b. Nga një kontratë sipërmarrjeje lidhur me shoqërinë “{***}” ShPK, për ndërtimin mbi truallin në bashkëpronësi të shtetasve N. V., A. V. dhe M. H., rezulton se të tri këta individë kanë përfutur njësi me të njëjtat sipërfaqe.

32.5. Në mbështetje të pretendimit se pasuria e trajtuar në procesin gjyqësor të referuar më sipër ka qenë vetëm në pronësi të vjehrrit, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur vërtetimin e referuar në shkronjën “b” të paragrafit 33.4 më sipër. Gjatë procesit të rivlerësimit është administruar edhe një deklaratë noteriale e datës 27.9.2019, ku deklaruesi A. V., ndër të tjera, pretendon se: “[...] *Lidhur me të ardhurat e vendimit gjyqësor [...] në vlerën 1.956.570 lekë deklaroj se nuk kam marrë asnjë përfutim, pasi sipas vërtetimit, datë 23.11.1992, kjo pasuri, e cila ishte në bashkëpronësi me familjen M., i është dhënë prej babait E., vetëm të ndjerit vëllait N. V.. Me ekzekutimin e vendimit gjyqësor të sipërcituar është marrë znj. L. V. dhe unë së bashku me të ndjerën motrën M. H. e kemi zgjidhur me mirëkuptim duke mos marrë asnjë përfutim nga vlera 1.956.570 lekë, pasi kjo shumë i takonte me ligj të ndjerit vëllait N. V. e, më tej, edhe trashëgimtarëve të tij ligjorë [...]*”.

32.6. Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se mënyra sesi palët kanë vepruar për të rivendosur të drejtat e tyre nëpërmjet procesit gjyqësor në të tria shkallët, sikurse edhe veprimet juridike që i kanë paraprirë atij – kontrata e sipërmarrjes cituar në paragrafi 33.4/c – nuk përputhet me sa pretendohet nga subjekti dhe as nga deklarata noteriale e prodhuara gjatë procesit të rivlerësimit. Për të njëjtën arsye, nga aktet nuk provohet heqja dorë nga pjesa takuese e shumës që i takonte trashëgimtares tjetër, znj. M. H.

32.7. Trupi gjykues i Kolegjit, pasi i analizoi të gjitha rrethanat e sipërcituara dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, e vlerësoi pa peshë e jo përcaktues në vendimmarrjen përfundimtare dhe zgjidhjen e çështjes këtë shkak ankimi.

33. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit, pasi analizoi pretendimet e ngritura nga subjekti i rivlerësimit në ankim, shqyrtoi provat shkresore të administruara në dosjen gjyqësore të kësaj çështjeje, bazuar në konkluzionet e mësipërme, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Arjan Balliu, gjendet në kushtet e parashikuara në pikat 1 dhe 3, neni D i Aneksit të Kushtetutës, si dhe në pikën 3, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Për pasojë, vendimi nr. 211, datë 18.11.2019, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për shkarkimin e tij nga detyra, është i mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 211, datë 18.11.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, z. Arjan Balliu.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 28.07.2022.

ANËTARE

Albana Shtylla

nënshkrimi

ANËTARE

Ina Rama

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol Çomo

nënshkrimi

RELATORE

Rezarta Schuetz

nënshkrimi

KRYESUESE

Natasha Mulaj

nënshkrimi